



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government

**MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK
MINISTARSTVO EKONOMSKOG RAZVOJA
MINISTRY OF ECONOMIC DEVELOPMENT**

**PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT PËR BURIMET E RIPËRTËRISHME TË ENERGJISË
I REPUBLIKËS SË KOSOVËS 2011-2020**

PERIUDHA 2018-2020

Final

Prishtinë

KORRIK 2018

Përmbajtja

1. PËRMBLEDHJE E POLITIKËS SHTETËRORE TË ENERGISË NGA BURIMET E RIPËRTËRISHME	1
2. PARASHIKIMI I KONSUMIT FINAL TË ENERGISË 2010-2020	5
3. CAQET DHE TRAJKTORET E ENERGISË NGA BURIMET E RIPËRTËRISHME	7
3.1. Caku i përgjithshëm shtetëror	7
3.2. Caqet dhe trajektoret sektoriale	7
4. MASAT PËR ARRITJEN E CAQEVE	12
4.1. Pasqyrë e të gjitha politikave dhe masave për promovimin e shfrytëzimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme	12
4.2. Masat specifike për përmbushjen e kërkesave sipas neneve 13, 14, 16 si dhe neneve 17 deri në 21 të Direktivës 2009/28/KE	17
4.3. Skemat mbështetëse të aplikuara në Kosovë për promovimin e shfrytëzimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme në energjinë elektrike.....	33
4.4. Skemat mbështetëse të aplikuara në Kosovë për promovimin e shfrytëzimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme në ngrohje dhe ftohje	36
4.5. Skemat mbështetëse për promovimin e shfrytëzimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme në transport, të aplikuara nga Shtetet Anëtare, apo një grup Shtetesh Anëtare..	37
4.6. Masat specifike për promovimin e shfrytëzimit të energjisë nga biomasa	38
4.7. Shfrytëzimi i planifikuar i transferimeve statistikore ndërmjet Shteteve Anëtare dhe pjesëmarrja e planifikuar në projekte të përbashkëta me Shtetet tjera Anëtare dhe vendet e treta	44
5. VLERËSIMET	46
5.1. Kontributi total i pritur nga secila teknologji e energjisë së ripërtërishme për arritjen e caqeve obligative të vitit 2020 si dhe trajektorja indikative e përkohshme për pjesën e energjisë nga burimet e ripërtërishme në energji elektrike, ngrohje e ftohje, si dhe transport .	46
5.2. Kontributi total i pritur nga masat e efijencës së energjisë dhe kursimit të energjisë për arritjen e caqeve obligative të vitit 2020 si dhe trajektorja indikative e përkohshme për pjesën e energjisë nga burimet e ripërtërishme në energji elektrike, ngrohje e ftohje, si dhe transport	52

Tabelat

Tabela 1: Caqet e përgjithshme shtetërore për pjesën e energjisë nga BRE-të më 2020.....	1
Tabela 2: Përparimi drejt përmbushjes së caqeve për BRE	3
Tabela 3: Caqet e planifikuara për BRE deri më 2020.....	4
Tabela 4: Konsumi i pritur bruto final i energjisë në Kosovë në ngrohje e ftohje, energji elektrike dhe transport deri më 2020, duke marrë parasysh efektet e efijencës së energjisë dhe masat e kursimit të energjisë (ktoe).	6
Tabela 5: Caku i përgjithshëm shtetëror për pjesën e energjisë nga burimet e ripërtërishme në konsumin final bruto të energjisë më 2009 dhe 2020.	7
Tabela 6: Caku shtetëror për 2020 si dhe trajektorja e projektuar e energjisë nga burimet e ripërtërishme në ngrohje e ftohje, energji elektrike dhe transport.....	8
Tabela 7: Tabela e kalkulimit për kontributin e energjisë së ripërtërishme të secilit sektor në konsumin final të energjisë.	9
Tabela 8: Tabela e kalkulimit për energjinë nga burimet e ripërtërishme në pjesën e transportit.	10
Tabela 9: Pasqyra e politikave dhe masave ekzistuese.	12
Tabela 10: Pasqyra e politikave dhe masave ekzistuese.	16
Tabela 11: Pjesëmarrja e vlerësuar e energjisë nga burimet e ripërtërishme në sektorin ndërtimor....	24
Tabela 12: Furnizimi i biomasës më 2009.....	39
Tabela 13: Furnizimi i vlerësuar vendor i biomasës më 2015 dhe 2020.....	41
Tabela 14: Shfrytëzimi aktual i tokës bujqësore për prodhimin e kulturave të dedikuara për energji në vitin 2009.	42
Tabela 15: Prodhimi i vlerësuar i tepërt dhe/ose i mangët i energjisë nga burimet e ripërtërishme, krahasuar me trajektoren indikative, që mund të transferohen në/nga Shtetet tjera Anëtare në Kosovë.	45
Tabela 16: Potenciali i disponueshëm në Kosovë për secilën teknologji të energjisë nga burimet e ripërtërishme në energji elektrike, për periudhën 2009-2014.....	47
Tabela 17: Potenciali i disponueshëm në Kosovë për secilën teknologji të energjisë nga burimet e ripërtërishme në energji elektrike, për periudhën 2015-2020.....	48
Tabela 18: Potenciali i disponueshëm në Kosovë për secilën teknologji të energjisë nga burimet e ripërtërishme në ngrohje-ftohje, për periudhën 2009-2020 (ktoe).	49
Tabela 19: Potenciali i disponueshëm në Kosovë për secilën teknologji të energjisë nga burimet e ripërtërishme në transport, për periudhën 2009-2020 (ktoe).	50

Figurat

Figura 1: Përparimi drejt përmbushjes së caqeve për BRE-Total	3
Figura 2: Konsumi fundor sipas sektorëve më 2015.	52

1. PËRMBLEDHJE E POLITIKËS SHTETËRORE TË ENERGJISË NGA BURIMET E RIPËRTËRISHME

Burimet e Ripërtërishme të Energjisë (BRE) përbëjnë një element të rëndësishëm të sektorit të energjisë në Kosovë, siç edhe përcaktohet me Strategjinë e Energjisë të Republikës së Kosovës 2017-2026. Strategjia e Energjisë e Kosovës 2017-2026 vendos objektivat themelore të Qeverisë së Kosovës për zhvillimin e sektorit të energjisë, promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, mbrojtjen e mjedisit, furnizimin e qëndrueshëm dhe të besueshëm të energjisë tek konsumatorët fundorë, shfrytëzimin efikas të energjisë, zhvillimin e kapaciteteve të reja konvencionale dhe të ripërtërishme të gjenerimit, krijimin e tregut konkurrues, zhvillimin e sistemit të gazit, si dhe krijimin e vendeve të reja të punës në sektorin e energjisë. Strategjia e Energjisë 2017-2026 mundëson promovimin e BRE-ve, duke përfunduar masat e mëtutjeshme fiskale e financiare për BRE-të si dhe kornizën ligjore dhe rregullative.

Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë (PKVBRE) për periudhën 2011-2020 është dorëzuar më 2013, duke caktuar nën-caqet specifike në kuadër të caktuar kryesore prej 25%, si dhe duke propozuar masat për arritjen e tyre deri më 2020. Kosova ka vendosur, në kuadër të këtij versioni të parë të PKVBRE-së të zbatohet një cak të dytë, edhe më ambicioz sesa ai i përgjithshëm i detyrueshëm shtetëror për pjesëmarrjen e BRE-ve në konsumin bruto final të energjisë për vitin 2020. Kjo është përcaktuar në vendimin e Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë D/2012/04/MC-EnC për zbatimin e Direktivës 2009/28/EC që ndryshon nenin 20 të Traktatit të Komunitetit të Energjisë. PKVBRE-ja ka përmendur që Kosova mëton të përmbushë e të tejkalojë cakun e vet të detyrueshëm shtetëror përmes marrjes së masave shtetërore për promovimin e BRE-ve, pa synuar eksploatimin e mekanizmave të ndryshëm fleksibilë të bashkëpunimit, si projektet dhe skemat e përbashkëta. Ky cak i dytë është vënë tek shifra prej 29.47% të konsumit të pritur bruto final të energjisë më 2020.

Pasqyra e caktuar të përgjithshëm shtetëror për pjesëmarrjen e BRE-ve në konsumin bruto final të energjisë për vitin 2020, siç është përcaktuar në vitin 2013, është paraqitur tek Tabela 1.

Tabela 1: Caqet e përgjithshme shtetërore për pjesën e energjisë nga BRE-të më 2020

Figura	Obligative	Vullnetare
Caku i energjisë nga burimet e ripërtrishme në konsumin përfundimtar bruto të energjisë (%)	25%	29.47%
Konsumi i pritur total i energjisë korrigjuar (ktoe)	1729.82	1729.82
Sasia e pritur e energjisë nga burime të ripërtrishme që i përgjigjen caktuar të vitit 2020 (ktoe)	432.46	509.70

Burimi: PKVBRE, 2013.

Arritja e caqeve vjetore të energjisë nga BRE-të është paraparë të përmbushet nga pjesëmarrja e teknologjive specifike të BRE-ve në gjenerimin e energjisë elektrike (BRE-E), në prodhimin e ngrohjes dhe ftohjes (BRE-N), si dhe në sektorin e transportit (BRE-T). Në këtë drejtim, janë vendosur tre nën-caqe të ndryshme ashtu që të lehtësohet arritja e caktuar të energjisë nga BRE-të për vitin 2020.

Këta tre nën-caqe në versionin e vitit 2013 të PKVBRE-së kanë qenë si vijon:

- **25.64% pjesëmarrjen të BRE-ve në konsumin bruto final të energjisë elektrike**, që duhet të arrihet me instalimin e hidrocentraleve të vogla (240 MWe), hidrocentralit të Zhurit 305 MWe), impianteve me erë (150 MWe), impianteve me biomasë (14 MWe) si dhe impianteve fotovoltaike (10 MWe).
- **10% pjesëmarrjen të BRE-ve në konsumin përfundimtar në transport**, që duhet të arrihet me shtrirjen e bio-karburanteve.
- **45.65% pjesëmarrjen të BRE-ve në konsumin përfundimtar të ngrohjes dhe ftohjes**, që duhet të arrihet me promovimin e energjisë diellore (70 MWth), pompave gjeotermike të ngrohjes (10 MWth) si dhe biomasës në formën e druve tradicionalë të zjarrit.

Më 2017, u vendos edhe vlerësimi i progresit aktual në lidhje me arritjen e caqeve të vendosura, ashtu që të përditësohen edhe caqet e specifikuar por edhe politikat e parapara. Dorëzimi i planit të rishikuar kombëtar të veprimit nga burimet e ripërtërishme të energjisë deri më 30 qershor 2018, për shkak të devijimeve më të mëdha se 1 pikë përqindjeje nga trajektorja indikative e regjistruar gjatë periudhës 2014-2015, është kërkuar nga Këshilli Ministror, duke marrë parasysh Raportin e Dytë të Sekretariatit mbi progresin në Promovimin e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme në Komunitetin e Energjisë 2014-2015.

Në vlerësim (dokument i veçantë) si dhe këtë PKVBRE të rishikuar, vlerësimi i caktimit të BRE-ve për vitin 2020 (BRE-Total) u bë përmes veglës SHARES¹, duke marrë të dhënat për Kosovën, që janë në dispozicion tek Eurostat-i.

Figura 1 paraqet progresin e penetrimit të BRE-ve në krahasim me caqet e vendosura për vitin 2020 për BRE-Total, derisa rezultatet analitike janë paraqitur në Tabelën 2.

¹ Vegla SHARES fokusohet tek kalkulimi i harmonizuar i pjesës së energjisë nga burimet e ripërtërishme (brenda BE-së dhe Palëve kontraktuese të TKE-së). Shih <http://ec.europa.eu/eurostat/web/energy/data/shares>




Figura 1: Përparimi drejt përmbushjes së caqeve për BRE-Total

duhet theksuar që edhe caqet obligative edhe ato vullnetare siç janë caktuar me PKVBRE 2011-2020 janë paraqitur në Figurën 1, ashtu që të vlerësohet perspektiva për përmbushjen reale të caktut BRE-Total.

Tabela 2: Përparimi drejt përmbushjes së caqeve për BRE

	2009	2010	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Numëruesi BRE-E numerator (ktoe)	5.3	6.5	9.9	28.7	28.7	46.9	59.1	91.4
Numëruesi BRE-NeF (ktoe)	234.9	236,6	263,8	263.8	263.8	272.7	281.7	303.6
Numëruesi BRE-T (ktoe)	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	7.7	19.5	39.7
Gjithsej Numëruesi BRE Total (ktoe)	240.3	243.1	273.6	292.4	292.4	327.3	360.4	434.6
BKFE me korrigjim (ktoe)	1354.3	1379.3	1522.7	1,557.0	1,592.0	1,629.0	1,694.8	1,735.9
Emëruesi BRE-E (ktoe)	470.3	484.4	537.4	548.4	563.3	574.8	612.6	625.5
Emëruesi BRE-NeF (ktoe)	528.9	565.3	606.7	622.8	634.7	650.7	666.6	683.2
Emëruesi BRE-T (ktoe)	325.6	304.0	366.7	373.8	376.9	383.7	390.3	396.9
BRE-E [%]	1.1%	1.3%	1.8%	5.2%	5.1%	8.2%	9.7%	14.6%
BRE-NeF [%]	44.4%	41.8%	43.5%	42.4%	41.6%	41.9%	42.3%	44.4%
BRE-T [%]	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	2.0%	5.0%	10.0%
BRE-Gjithsej [%]	17.7%	17.6%	18.5%	18.8%	18.4%	20.1%	21.3%	25.0%

Tabela 3 paraqet evoluimin e caqeve të BRE-ve nga periudha 2011-2020 në pajtim me projeksionet e PKVBRE-së ekzistues, të vendosur më 2013, ashtu që të kuantifikohen devijimet në krahasim me vlerësimet e Tabelës 2.

Tabela 3: Caqet e planifikuara për BRE deri më 2020.

	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
BRE-E [%] - M	1.71%	2.16%	2.12%	5.13%	5.62%	6.58%	13.20%	14.42%	14.10%	14.33%
BRE-E [%]- V	1.71%	2.16%	2.16%	7.34%	13.78%	15.00%	21.60%	23.18%	23.39%	25.64%
BRE-NeF [%]	44.07%	46.45%	45.22%	44.91%	44.77%	44.84%	45.24%	45.37%	45.53%	46.45%
BRE-T [%]	0.04%	0.00%	0.00%	1.00%	2.00%	3.00%	4.00%	6.00%	8.00%	10.00%
BRE-Gjithsej [%]- M	17.65%	18.18%	18.25%	19.29%	19.66%	20.33%	23.20%	24.20%	24.42%	25.00%
BRE-Gjithsej [%]- V	17.65%	18.18%	18.25%	20.14%	22.80%	23.57%	26.45%	27.58%	28.09%	29.47%

Burimi: PKVBRE, 2013.

Sipas rezultateve të prezantuara, caku për BRE-NeF është arritur në masë të madhe (43.5% aktuale 2015 kundrejt planit për 2015: 44.77%). Përbushja e cakut obligativ total prej 25% nuk është e arritshme me politikat e përcaktuara me versionin 2013 të PKVBRE-së, si dhe masat plotësuese të zbatuara deri më 2018 (aktuale 2015: 18.0% kundrejt planit për 2015: 19.66%) me dizajnimin dhe zbatimin e masave dhe politikave specifike.

Devijime të konsiderueshme vërehen edhe për BRE-E (aktuale 2015: 1.8% kundrejt planit për 2015: 5.62%) si dhe caqeve BRE-T (aktuale 2015: 0% kundrejt planit për 2015: 2.00%) në krahasim me planin fillestar, duke penguar në masë të madhe arritjen e cakut BRE-Total duke marrë parasysh kohën e kufizuar për arritjen e synimeve BRE deri në fund të vitit 2020.

Kështu, synimi i këtij shqyrtimi të PKVBRE-së është identifikimi i një skenari pajtueshmërie, ashtu që të përmbushë caqet obligative në lidhje me pjesëmarrjen e BRE-ve në Kosovë.

2. PARASHIKIMI I KONSUMIT FINAL TË ENERGJISË 2010-2020

Vlerësimet e konsumit bruto përfundimtar të energjisë në periudhën deri më 2020 janë prezantuar në Tabelën 4, si dhe në bazë të dokumentit të quajtur Parashikimi i Kërkesës për Energji, që mbulon periudhën 2013-2022.

Shifrat për konsumin final bruto të energjisë deri më 2015 janë nxjerrë nga kalkulimet me veglën SHARES, duke marrë parasysh të dhënat zyrtare statistikore, derisa vlerësimet deri më 2020 janë bazuar në evoluimin e shifrave korresponduese, siç përcaktohet me PKVBRE në ekzistues.

Tabela 4: Bruto konsumi final i parashikuar i energjisë në Kosovë në ngrohje e ftohje, energji elektrike dhe transport deri më 2020, duke marrë parasysh efektet e eficientës së energjisë dhe masat e kursimit të energjisë (ktoe).

	2009	2010	2011	2012	2013	2014
	Viti bazë	Eficientia plotësuese e energjisë				
(1) ngrohja dhe ftohja ⁽²⁾	528.9	565.3	596.6	534.9	559.7	537.8
(2) energjia elektrike ⁽³⁾	470.3	484.4	534.7	524.2	531.6	509.6
(3) transporti sipas Nenit 3(4)a ⁽⁴⁾	325.6	304.0	315.3	319.4	306.1	331.7
(4) Konsumi bruto final i energjisë ⁵	1,354.3	1,379.3	1,472.2	1,404.9	1,423.1	1,388.9
	2015	2016	2017	2018	2019	2020
	Eficientia plotësuese e energjisë					
(1) ngrohja dhe ftohja ⁽⁶⁾	606.7	622.8	634.7	650.7	666.6	683.2
(2) energjia elektrike ⁽⁷⁾	537.4	548.4	563.3	574.8	612.6	625.5
(3) transporti sipas Nenit 3(4)a ⁽⁸⁾	366.7	373.8	376.9	383.7	390.3	396.9
(4) Konsumi bruto final i energjisë ⁹	1,522.7	1,557.0	1,592.0	1,629.0	1,694.8	1,735.9

² Është konsumi final i energjisë i të gjitha formave të energjisë, përveç energjisë elektrike për qëllime që nuk janë transport, plus konsumi vetanak i ngrohjes në impiantet e energjisë elektrike dhe ngrohjes si dhe humbjet e ngrohjes në rrjete (pikat '2. Konsumi vetanak nga impiantet' dhe '11. Humbjet në transmision dhe distribucion nga Rregullorja (EC) Nr. 1099/2008 (f. 23-24).

³ Konsumi bruto i energjisë elektrike është prodhimi shtetëror bruto i energjisë elektrike, duke përfshirë auto-prodhimin, plus importet, minus eksportet

⁴ Konsumi në transport sipas përkufizimit tek neni 3(4)(a) i Direktivës 2009/28/EC. Energjia elektrike e ripërtërishme në transportin rrugor në këtë figurë duhet shumëzuar me një faktor prej 2,5, siç theksohet tek neni 3(4)(c) të Direktivës 2009/28/EC.

⁵ Sipas përkufizimit tek neni (2)(a) i Direktivës 2009/28/EC. Kjo përfshin konsumin final të energjisë plus humbjet në rrjet dhe konsumin vetanak të ngrohjes dhe energjisë elektrike në impiantet e energjisë elektrike dhe ngrohjes (NB: Kjo nuk përfshin konsumin e energjisë elektrike për hidro-depozitimin me pompa apo për transformimin në kazanë elektrike apo pompa të ngrohjes në impiantet e ngrohjes qendrore).

⁶ Është konsumi final i energjisë i të gjitha formave të energjisë, përveç energjisë elektrike për qëllime që nuk janë transport, plus konsumi vetanak i ngrohjes në impiantet e energjisë elektrike dhe ngrohjes si dhe humbjet e ngrohjes në rrjete (pikat '2. Konsumi vetanak nga impiantet' dhe '11. Humbjet në transmision dhe distribucion nga Rregullorja (EC) Nr. 1099/2008 (f. 23-24).

⁷ Konsumi bruto i energjisë elektrike është prodhimi shtetëror bruto i energjisë elektrike, duke përfshirë auto-prodhimin, plus importet, minus eksportet

⁸ Konsumi në transport sipas përkufizimit tek neni 3(4)(a) i Direktivës 2009/28/EC. Energjia elektrike e ripërtërishme në transportin rrugor në këtë figurë duhet shumëzuar me një faktor prej 2,5, siç theksohet tek neni 3(4)(c) të Direktivës 2009/28/EC.

⁹ Sipas përkufizimit tek neni (2)(a) i Direktivës 2009/28/EC. Kjo përfshin konsumin final të energjisë plus humbjet në rrjet dhe konsumin vetanak të ngrohjes dhe energjisë elektrike në impiantet e energjisë elektrike dhe ngrohjes (NB: Kjo nuk përfshin konsumin e energjisë elektrike për hidro-depozitimin me pompa apo për transformimin në kazanë elektrike apo pompa të ngrohjes në impiantet e ngrohjes qendrore).

3. CAQET DHE TRAJKTORET E ENERGJISË NGA BURIMET E RIPËRTËRISHME

3.1. Caku i përgjithshëm

Caku i përgjithshëm obligativ shtetëror për pjesëmarrjen e energjisë nga BRE-të në konsumin final bruto të energjisë në vitin 2020 është 25%, sipas Vendimit të Këshillimit Ministror të Komunitetit të Energjisë D/2012/04/MC-EnC për zbatimin e Direktivës 2009/28/EC, si dhe për ndryshimin e nenit 20 të Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

Prioritet është përmbushja e caktimit obligativ për pjesëmarrjen e BRE-ve prej 25% deri më 2020. Kështu, caku obligativ prej 25% definohet si cak i rishikuar për Kosovën duke marrë parasysh penetrimin e BRE-ve deri më 2020. Për më tepër, mekanizmat e mbështetjes financiare që përdoren (tarifat hyrëse) janë në dispozicion për të arritur cakun vullnetar, ashtu që të tërhiqen më shumë investitorë në sektorin e BRE-ve.

Tabela 5: Caku i përgjithshëm shtetëror për pjesën e energjisë nga burimet e ripërtërishme në konsumin final bruto të energjisë më 2009 dhe 2020.

(A) Pjesëmarrja e energjisë nga burimet e ripërtrishme në konsumin final bruto të energjisë më 2009 (S₂₀₀₉):	17.7%
(B) Pjesëmarrja e energjisë nga burimet e ripërtrishme në konsumin final bruto të energjisë më 2020 (S₂₀₂₀):	25%
(C) Totali i Konsumit final të parashikuar të energjisë më 2020	1,735.9 ktoe
(D) Shuma e parashikuar e energjisë nga burime të ripërtrishme që korrespondon me cakun e vitit 2020	434.6 ktoe

Pasi që Kosova planifikon të arrijë cakun e saj shtetëror obligativ përmes masave shtetërore për prodhimin e energjisë nga burimet e ripërtërishme, ekziston mundësia ose të barten sasitë e tepërta mbi trajektoren indikative ose të bartet sasia e nevojshme për të arritur cakun me anë të mekanizmave fleksibilë të bashkëpunimit, përmes kapaciteteve të tepërta nga palët tjera kontraktuese. Megjithatë, për momentin, kjo nuk planifikohet nga qeveria, pasi që preferenca është arritja e BRE-ve me resurse të brendshme. Në anën tjetër, nëse raporti i rregullt mbi implementimin e këtij PSHVER-je si dhe përparimi në arritjen e caqeve tregojnë që Kosova nuk arrin të përmbushë caqet obligative vetëm me prodhimin vendor, do të merren hapa adekuatë për të hulumtuar mundësitë e përdorimit të mekanizmave të tillë të bashkëpunimit (për shembull me Shqipërinë apo Malin e Zi).

3.2. Caqet dhe trajektoret sektoriale

Caqet për tre sektorët (energji elektrike, transporti dhe sektori i ngrohjes dhe ftohjes), të cilët do të kontribuojnë në përmbushjen e caktimit të përgjithshëm janë kalkuluar (me modelin SHARES dhe të dhënat e Eurostat-it) si vijon:

- 14.6% BRE në konsumin final bruto të energjisë elektrike
- 10% BRE në konsumin final të energjisë në transport
- 44.4% BRE në konsumin final bruto për ngrohje dhe ftohje

Në sektorin e energjisë elektrike, rritjet e gjenerimit të BRE-ve bazohen në zhvillimin e:

- Hidrocentraleve të vogla dhe të mesme (124.1 MW)
- Turbinat e erës (173.8 MW) si dhe
- Panelet fotovoltaike (30 MW).

Për promovimin e BRE-ve në ngrohje dhe ftohje, parashihet ndërtimi i ngrohtores në Gjakovë (që vlerësohet të arrijë prodhim vjetor prej 45,346 MWh_{th} ngrohje dhe 6,232 MWh_e energji elektrike), promovimi i pompave të ngrohjes gjeotermike (10 MW_{th}), instalimi i kolektorëve solarë për ujë të ngrohtë në shtëpi (100,000 m²) si dhe promovimi i bojlerëve dhe stufave të efikasitetit të lartë me biomasë në sektorin amvisnor dhe shërbyes (25% zëvendësim të energjisë së konsumuar nga lëndët e ngurta dhe ato të naftës më 2015).

Për përdorimin e BRE-ve në sektorin e **transportit**, legjislacioni planifikohet për të arritur 10% deri në fund të vitit 2020.

Tabela 6 paraqet cakun shtetëror për 2020 si dhe trajektoren e projektuar të energjisë nga BRE-të në ngrohje e ftohje, energji elektrike dhe transport. Tabelat 7 dhe 8 përfshijnë të gjitha të dhënat e nevojshme për kalkulimin e nën-capeve të BRE-ve.

Tabela 6: Caku shtetëror për 2020 si dhe trajektorja e projektuar e energjisë nga burimet e ripërtërishme në ngrohje e ftohje, energji elektrike dhe transport.

	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
BRE-NeF ¹⁰	44.4%	41.8%	40.6%	46.3%	44.3%	46.8%	43.5%	42.4%	41.6%	41.9%	42.3%	44.4%
BRE-E ¹¹	1.1%	1.3%	1.4%	1.5%	1.6%	1.9%	1.8%	5.2%	5.1%	8.2%	9.7%	14.6%
BRE-T ¹²	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	2.0%	5.0%	10.0%
Pjesëmarrja e përgjithshme e BRE-ve ¹³	17.7%	17.6%	16.9%	18.2%	18.0%	18.8%	18.0%	18.8%	18.4%	20.1%	21.3%	25.0%
Nga të cilat, me mekanizma bashkëpunimi ¹⁴	Nuk vlen											0
Suficiti për mekanizma	Nuk është në dispozicion											

¹⁰ Pjesa e energjisë së ripërtërishme në ngrohje e ftohje: konsumi final bruto i energjisë nga burimet e ripërtërishme për ngrohje e ftohje (sipas përkufizimit tek nenet 5(1)b) dhe 5(4) të Direktivës 2009/28/EC) pjesëtuar me konsumin final bruto të energjisë për ngrohje e ftohje. Linja (A) nga Tabela 4a pjesëtuar me linjën (1) të Tabelës 1.

¹¹ Pjesa e energjisë së ripërtërishme në energji elektrike: konsumi final bruto i energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme për energji elektrike (sipas përkufizimit tek nenet 5(1)(a) dhe 5(3) të Direktivës 2009/28/EC) pjesëtuar me konsumin total final bruto të energjisë elektrike. Rreshti (A) nga Tabela 4a pjesëtuar me rreshtin (2) të Tabelës 1.

¹² Pjesa e energjisë së ripërtërishme në transport: energjia finale nga burimet e ripërtërishme konsumuar në transport (cf. Neni 5(1)(c) dhe 5(5) i Direktivës 2009/28/EC) pjesëtuar me konsumin në transport të 1) benzinës; 2) dizelit; 3) bio-lëndëve të përdorura në transport rrugor dhe hekurudhor si dhe 4) energjia elektrike në transportin tokësor (siç pasqyrohet në rreshtin 3 të Tabelës 1). Linja (J) nga Tabela 4b pjesëtuar me rreshtin (3) të Tabelës 1.

¹³ Pjesa e energjisë së ripërtërishme në konsumin final bruto të energjisë. Rreshti (G) nga Tabela 4a pjesëtuar me rreshtin (4) të Tabelës 1.

¹⁴ Në pikë përqindjeje të hisjes së përgjithshme të BRE-ve.

bashkëpunimi¹⁶

Pjesa B e Shtojcës I të Direktivës	2011-2012	2013-2014	2015-2016	2017-2018		2020
	S ₂₀₀₉ +20% (S ₂₀₂₀ -S ₂₀₀₉)	S ₂₀₀₉ +30% (S ₂₀₂₀ -S ₂₀₀₉)	S ₂₀₀₉ +45% (S ₂₀₂₀ -S ₂₀₀₉)	S ₂₀₀₉ +65% (S ₂₀₂₀ -S ₂₀₀₉)		S ₂₀₂₀
Trajektorja minimale BRE ¹⁵ %	19.2%	19.9%	21%	22,5%		25%
Trajektorja minimale BRE (ktoe)	279.1	298.6	327.7	366.6		434.6

Tabela 7: Tabela e kalkulimit për kontributin e energjisë nga burimet e ripërtërishme të secilit sektor në konsumin final të energjisë.¹⁶

(ktoe)	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
(A) Konsumi i pritur final bruto i BRE-ve për ngrohje dhe ftohje	234.9	236.6	242.2	247.8	247.9	251.8	263.8	263.8	263.8	272.7	281.7	303.6
(B) Konsumi bruto final i energjisë elektrike nga BRE-të	5.3	6.5	7.3	7.8	8.6	9.5	9.9	28.7	28.7	46.9	59.1	91.4
(C) Konsumi bruto final i energjisë nga BRE-të në transport	0.0	0,0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	19.5	39.7
(D) Konsumi i pritur total i BRE-ve ¹⁷	240.3	243.1	249.4	255.6	256.6	261.3	273.6	292.4	292.4	319.6	360.4	434.6

¹⁵ Sipas përkufizimit tek Shtojca I.B e Direktivës 2009/28/EC.

¹⁶ Numrat mund të mos llogariten mirë për shkak të rrumbullakësimeve

¹⁷ Sipas nenit 5(1) të Direktivës 2009/28/EC, gazi, energjia elektrike dhe hidrogjeni nga burimet e ripërtërishme të energjisë merren në konsideratë vetëm një herë. Nuk lejohet numërimi i dyfishtë.

(E) Transferimi i pritur i BRE-ve tek Shtetet tjera Anëtare												
(F) Transferimi i pritur i BRE-ve nga Shtetet tjera Anëtare dhe vendeve të treta												
(G) Konsumi i pritur i BRE-ve korrigjuar për cakun (D)-(E)+(F)	240.3	243.1	249.4	255.6	256.6	261.3	273.6	292.4	292.4	319.6. 3	360.4	434.6

Tabela 8: Tabela e kalkulimit për energjinë e ripërtërishme në hisen e transportit.

(ktoe)	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
(C) Konsumi i pritur i BRE-ve në transport ¹⁸	0.0	0.0	0,0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	19.5	39.7
(H) Energjia elektrike BRE e pritur në transportin rrugor ¹⁹												
(I) Konsumi i pritur i bio-karburanteve nga mbeturinat, materialet celuloide jo-ushqimore dhe lingo-celuloide në transport												
(J) Kontributi i pritur i BRE-ve në transport për cakun BRE-T:	0.0	0.0	0.0	0.0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0.0	19.5	39.7

¹⁸ Përmban të gjitha BRE-të e përdorura në transport, duke përfshirë energjinë elektrike, hidrogjenin dhe gazin nga burime të ripërtërishme të energjisë, duke përjashtuar bio-kaburantet që nuk janë në përputhje me kriteret e qëndrueshmërisë (cf. Neni 5(1) nën-paragrafi i fundit). Të specifikohen vlerat aktuale pa përdorur faktorët e multiplikimit.

¹⁹ Të specifikohen vlerat aktuale pa përdorur faktorët e multiplikimit.

$(C - + (2,5 - 1) \times -H)$ $+ (2 - 1) \times (I)$												
---	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

4. MASAT PËR ARRITJEN E CAQEVE

4.1. Pasqyrë e të gjitha politikave dhe masave për promovimin e shfrytëzimit të energjisë nga burimet e ripërtërishe

Masat ekzistuese janë prezantuar në tabelën 9, derisa masat e planifikuara janë prezantuar tek Tabela 10, të ndara sipas produktit energjetik: energjia elektrike, ngrohja dhe ftohja, transporti dhe masat ndërsektorale.

Tabela 9: Pasqyra e politikave dhe masave ekzistuese.

	Emri dhe referenca e masës	Lloji i masës	Rezultati i pritur	Grupi apo aktiviteti i synuar	Datat e (fillimit dhe) përfundimit të masës
Energjia elektrike					
1	Studimi i para-fizibilitetit për hidrocentralet e vogla	Studimi i vlerësimit	Identifikimi i hidropotencialeve	Investitorët në HCV	2006-
2	Vlerësimi i mëtuqjeshëm i hidro-potencialit energjetik	Studimi i vlerësimit	Identifikimi i hidropotencialeve	Investitorët në HCV	2009-2010
3	Hartimi i pakos tenderuese për ndërtimin e hidrocentraleve të vogla	Rregullatori	përsheptimi i procedurave të tenderimit për HCV	Mbështetja për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë dhe investitorët	2008-2010
4	Harta e energjisë së erës	Studimi	Hartimi i atlasit të energjisë së erës	Institucionet publike, planifikuesit dhe investitorët	2013-
5	Studimi për sigurinë e furnizimit të energjisë elektrike në Kosovë	Studimi	Masat e zgjerimit të rrjetit të BRE dhe kriteret teknike për impiantet me energji ere	Kompanitë energjetike, investitorët	2013-
6	Rregulli për procedurën e autorizimit të ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese (Rregulli i Autorizimit)	Rregullatori	përshkrimi i procedurës për autorizimin e projekteve të gjenerimit të energjisë	Investitorë, planifikues	2014-2017
7	Programi për Zhvillim Rural dhe Bujqësor - Skema e granteve për bujq	Përkrahje financiare	Qëndrueshmëria e sektorit dhe puna e përbashkët në rritje të prodhimit,	Bujqit	2014-

	Emri dhe referenca e masës	Lloji i masës	Rezultati i pritur	Grupi apo aktiviteti i synuar	Datat e (fillimit dhe) përfundimit të masës
			krijimi i linjave të reja përpunuese dhe avancimi i makinerive e pajisjeve bujqësore, si dhe kushteve të punës në nivel ferme		
8	Ligji për Energjinë nr.05/L-081	Rregullatore	Promovimi, optimizimi dhe shfrytëzimi, duke përfshirë përcaktimin e qëllimeve vjetore dhe afatgjate të gjenerimit të energjisë nga burimet e tilla	Investitorët, konsumatorët fundorë, administrata publike,	2016
9	Ligji për Energjinë Elektrike nr.05/L-085	Rregullatore	Krijimi i Certifikatës së Origjinës për BR dhe ko-gjenerim	Investitorët, konsumatorët fundorë, administrata publike,	2016
10	Ligji për Rregullatorin e Energjisë nr. 05/L-084, neni 43	Rregullatore	Vendosja e procedurave specifike “për autorizimin e ndërtimit të gjeneratorëve të vegjël të decentralizuar dhe/ose të shpërndarë”	Investitorët, konsumatorët fundorë, administrata publike,	2016
11	Rregulli për skemën mbështetëse (për mbështetjen e gjenerimit të energjisë elektrike nga BRE-të)	Rregullatore	Mbështetja e gjenerimit të energjisë elektrike nga BRE	Investitorë, planifikues	2014-2017-
12	Hartimi i skemës së tarifës nxitës feed in tarif për energjin nga burimet e ripërtërishme dhe	Rregullatore	Rritja e gjenerimit të energjisë elektrike nga biomasa dhe interesimi publik	Investitorë, planifikues	2018-

	Emri dhe referenca e masës	Lloji i masës	Rezultati i pritur	Grupi apo aktiviteti i synuar	Datat e (fillimit dhe) përfundimit të masës
	modelit financiar për biomasë		për investime në sektorin e biomasës		
13	Procedura për autorizimin e ndërtimit të gjeneratorëve të vegjël të decentralizuar dhe/ose të shpërndarë (rregullorja Prosumer)	Rregullatore	Rritja e gjenerimit të energjisë elektrike nga sistemet e vogla të decentralizuara FV dhe mundësia e kyçjes në rrjet	Amvisëritë, investitorët	2017-
14	Rregullorja nr. 05/2018 për One Stop Shop për BRE	Institucionale	Mundësimi i projekteve të BRE-ve ndërmjet aktiviteteve informuese dhe koordinuese	Institucionet qendrore, ZRRE, MMPH, si dhe institucionet lokale; investitorët privatë	2018-
Ngrohja dhe ftohja					
1	Studimi për shfrytëzimin e energjisë diellore	Studim	identifikimi i potencialit diellor	Investitorët dhe institucionet	2010-
2	Formimi i grupimeve (cluster) për rritje të shfrytëzimit të biomasës (peletit) dhe atyre solare	Përkrahje financiare	Formimi i grupimeve që merren me të gjitha aspektet e prodhimit të peletit dhe zbatimi i projekteve me energji diellore	Prodhuesit e peletit, prodhuesit e pajisjeve për dru, instaluesit e paneleve diellore, si dhe sistemeve FV	2014-
3	Ligji për Energjinë Termike	Rregullatore	Rritja e BRE-ve në prodhimin e ngrohjes	Investitorë, planifikues	2015-
4	Ligji për performancën energjetike	Rregullatore	rritja e shfrytëzimit të BRE-ve në objekte të reja dhe objekte që renovohen në masë të madhe	Investitorë, instalues	2016-
Transporti					

	Emri dhe referenca e masës	Lloji i masës	Rezultati i pritur	Grupi apo aktiviteti i synuar	Datat e (fillimit dhe) përfundimit të masës
1	Studimi për zhvillimin e prodhimit të energjisë nga bio-lëndët	Studim	Krijimi i databazës për përdorimin e bio-lëndëve dhe tërheqja e investimeve	Institucionet publike, planifikuesit dhe investitorët	2012-
Ndërsektorale					
1	Programi i Kosovës për Efiçencë të Energjisë dhe BRE	Promovim	Shfrytëzim më i mirë i energjisë nga BRE	Institucionet publike, konsumatorët, investitorët	2007-2009
2	Fushatë e vetëdijesimit publik për efiçencën e energjisë dhe BRE-të	Fushatë informuese	Informimi publik, nxitja e interesimit për përdorim të BRE-ve	Publiku i gjerë	Çdo vit, që prej 2009-tës
3	Fushatë e promovimit të BRE-ve	Masë e butë	Nxitja e interesimit të publikut për shfrytëzimin e BRE-ve	Konsumatorë, gjenerues, publiku	2012
4	Linja Kreditore KOSEP	Përkrahje financiare	Rritja e kapaciteteve të BRE-ve tek konsumatorët privatë, NVM-të	NVM-të, amvisëritë	2013-2017

Tabela 10: Pasqyra e politikave dhe masave ekzistuese.

	Emri dhe referenca e masës	Lloji i masës	Rezultati i pritur	Grupi apo aktiviteti i synuar	Datat e fillimit dhe përfundimit të masës
Energjia elektrike					
1	Skema mbështetëse për energjinë elektrike të prodhuar nga sistemet e vogla diellore	Rregullatore - financiare	Rritja e pjesëmarrjes të BRE-ve	Investitorë, instalues	2017-
2	Përgatitja e rregullave për ankandet për BRE-E (vazhdimësi e skemës së tarifës hyrëse)	Rregullatore	ndryshimi i legjislacionit dhe miratimi i Rregullave;	Investitorë	2019-
Ngrohja dhe ftohja					
1	promovimi i shfrytëzimit të BRE-ve për ngrohje/ftohje	Financiare	Rritja e penetrimit të BRE-ve	Investitorë, instalues	2018
2	Kuotat obligative për furnizuesit e ngrohjes qendrore për pjesën e BRE-ve në furnizimin e tyre	Rregullatore	Rritja e shfrytëzimit të BRE-ve në ngrohjen qendrore	Furnizuesit e Ngrohjes qendrore	2019
3	Bonusi në tarifa hyrëse nga shfrytëzimi i ngrohjes nga ko-gjenerimi me të ripërtërishme	Rregullatore - financiare	Rritja e shfrytëzimit të ngrohjes nga kogjenerimi me BRE	Investitorë, instalues	2019
4	Kërkesat minimale për BRE në ndërtesa	Rregullatore	Rritja e penetrimit të BRE-ve në ndërtesa	Investitorë, instalues	2019
Transporti					
1	Shfrytëzimi i bio-lëndëve Udhëzimi Administrativ për shfrytëzimin e BRE-ve në sektorin e transportit	Rregullatore	10% hise në përzierje në vitin 2020, skemat e certifikimit të qëndrueshmërisë dhe trupat e certifikimit	Distributorët, prodhuesit e bio-lëndëve	2018
2	Përfundimi nga taksa e akcizës për bio-lëndë	Fiskale	Rritja e konsumit të bio-lëndëve në sektorin e transportit	Ministria e Financave	2019
3	Pjesëmarrja e BRE-ve në transportin publik	Rregullatore Promovuese	Pjesëmarrja më e madhe e BRE-ve në transportin publik	Transport publik	2019
Ndërsektorale					

	Emri dhe referenca e masës	Lloji i masës	Rezultati i pritur	Grupi apo aktiviteti i synuar	Datat e fillimit dhe përfundimit të masës
1	Lirimi doganor për pjesë dhe pajisje për shfrytëzimin e BRE-ve	Fiskale	Përfitimi më i madh i projekteve të BRE-ve, tërheqja e investimet	Investitorë	2018
2	fitimi i liruar nga TVSH për investime në BRE	Fiskale	Përfitimi më i madh i projekteve të BRE-ve, tërheqja e investimet	Investitorë	2017-
3	Themelimi i Agjencive Rajonale të Energjisë	Rregullatore	Mbështetje për komunitat dhe ndërtesat me projekte BRE	Autoritetet qendrore dhe komunale, si dhe palë të tjera	2018
4	Instrumenti Financues për Ekonominë e Gjelbër (GEEF) për Ballkanin Perëndimor, përfshirë Kosovën	Financiare	Financimi i pajisjeve shtëpiake, përfshirë BRE	Amvisëritë	2017-2021

4.2. Masat specifike për përmbushjen e kërkesave sipas neneve 13, 14, 16 si dhe neneve 17 deri në 21 të Direktivës 2009/28/KE

4.2.1. Procedurat administrative dhe planifikimi hapësitor (neni 13(1) i Direktivës 2009/28/EC)

a) Legjislacioni ekzistues në lidhje me procedurat për autorizimin, certifikimin, licencimin dhe planifikimin hapësitor, që vlen për impiantet dhe rrjetin e infrastrukturës përkatëse të transmissiionit dhe distribucionit përfshin si vijon:

- Ligji nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë (GZ/Nr. 25 / 14 Korrik 2016).
- Ligji nr. 05/L-081 për Energjinë (GZ/Nr. 24 / 13 Korrik 2016).
- Ligji nr. 05/L-085 për Energjinë elektrike (GZ/Nr. 26 / 21 Korrik 2016).
- Ligji nr. 05/L-052 për Energjinë termike (GZ/Nr. 40/31 dhjetor 2015).
- Rregulli për mbështetjen e energjisë elektrike për të cilën është nxjerrë Certifikata e Origjinës dhe Procedurat e pranimit në skemën e mbështetjes, miratuar në dhjetor të vitit 2010 (ZRRE).
- Rregulli për licencimin e veprimtarive të energjisë në Kosovë, miratuar në mars të vitit 2017 (ZRRE).
- Rregulli për të ardhurat maksimale të lejuara të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Operatorit të Tregut, miratuar në mars të vitit 2017 (Rregulli për Çmimet e OST/OT)..
- Rregulli për të ardhurat maksimale të lejuara të Operatorit të Sistemit të Distribucionit, miratuar në mars të vitit 2017 (Rregulli për të Ardhurat e OSD-së)
- Rregulli për themelimin e sistemit të certifikatave të prejardhjes për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtërishme të energjisë, mbeturinave dhe ko-gjenerimit, kombinuar me ngrohje në një njësi të vetme të gjenerimit, miratuar në dhjetor 2010 (ZRRE).

- Rregulli për Skemën Mbështetëse për gjeneratorët me burime të ripërtërishme energjisë, miratuar në prill 2017 (ZRRE).
- Rregulli për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja nga burimet e ripërtërishme të energjisë, miratuar në prill të vitit 2017 (ZRRE).
- Ligji nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, (GZ/Nr. 10/29 prill 2013).
- Ligji nr. 04/L-144 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunave (GZ nr. 35/17 dhjetor 2012).
- Ligji nr. 04/L-110 për Ndërtimin (GZ/Nr. 18/03 korrik 2013).
- Ligji nr. 03/L- për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (GZ/Nr. 83/29 tetor 2010).
- Ligji nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit (GZ/Nr. 06 prill 2009).
- Ligji nr. 04/L-060 për Mbeturinat (GZ/Nr. 17/29 qershor 2012).
- Ligji nr. 03/L-153 për Pyjet e Kosovës (GZ/Nr. 34/25 shkurt 2010).
- Ligji nr. 03/L-043 për Parandalimin dhe kontrollimin e integruar të ndotjes (GZ/Nr. 52 08 maj 2009).
- Udhëzimi Administrativ Nr. 7/2017 për Lejet mjedisore.
- Udhëzimi Administrativ nr. 01/2017 për lëshimin e lejeve mjedisore komunale.
- Kodi i Rrjetit.
- Metodologjia e Tarifave të Kyçjes në Transmision/ KOSTT.
- Metodologjia e Tarifave të Kyçjes në Distribucion/ KEK.
- Rregullat teknike për kyçje.
- Rregullorja (GRK) nr. 05/2018 për one stop shop për burimet e ripërtërishme të energjisë.
- Udhëzimi Administrativ për shfrytëzimin dhe mbështetjen e gjenerimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme nr. 06/2017.
- Udhëzimi Administrativ për caqet e energjisë nga burimet e ripërtërishme të energjisë nr. 05/2017.

b) Institucionet përgjegjëse dhe kompetencat e tyre në këtë sferë:

Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE)

MZHE-ja është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave që inkurajojnë rritjen dhe bashkëpunimin ekonomik, zhvillimin e biznesit dhe ato që sigurojnë konkurrencën dhe zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të energjisë dhe të minierave.

Në kuadër të strukturës organizative të Ministrisë, departamenti përgjegjës është Departamenti i Energjisë (DE), më saktë Divizioni që merret me BRE, efikasitet energjetike dhe ko-gjenerim.

Përgjegjësitë kryesore të këtij divizioni janë:

- Propozimi, hartimi dhe sigurimi i zbatimit të dokumenteve të politikave dhe strategjive në fushën e BRE-ve, efikasitetit të energjisë dhe ko-gjenerimit.
- Propozimi, hartimi dhe sigurimi i zbatimit të legjislativitetit në fuqi në fushën e BRE-ve, EE-së dhe ko-gjenerimit.
- Monitorimi dhe hartimi i raporteve për zbatimin e dokumenteve të politikave dhe strategjive në fushën e burimeve të ripërtërishme, efikasitetit të energjisë dhe ko-gjenerimit.
- Koordinimi dhe raportimi mbi procesin e zbatimit të obligimeve që rrjedhin nga zotimet në Traktatin e Energjisë, në lidhje me burimet e ripërtërishme, efikasitetit të energjisë dhe ko-gjenerimit.

Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE)

- Autorizon ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese (Autorizimi Preliminar, Autorizimi Final).
- Vendos sistemin tarifor për gjenerimin e energjisë elektrike nga BRE-të.
- Përgjegjëse për sistemin e certifikatave të origjinës.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)

- Nxjerr kushtet e ujit, pajtueshmërisë ujore, lejet e ujit dhe urdhrat për ujëra, ose bart procedurën e dhënies së koncesioneve për përdorimin e ujit.
- Lëshon lejet mjedisore.
- Është përgjegjëse për lëshimin e Lejes së Ndërtimit (për gjeneratorë mbi 10 MW kapacitete të instaluar)

Autoritetet komunale

- Përgjegjëse për dhënien e tokës për përdorim nga projektet BRE.
- përgjegjëse për lëshimin e Lejes së Ndërtimit për gjeneratorë nën MW kapacitete të instaluar

Agjencia Pyjore e Kosovës

- Lejet për shfrytëzimin e pyjeve.

KOSTT

- Kycja në rrjetin e transmisionit; - Operimi i tregut.
- Balancimi i sistemit përmes mekanizmit të balansimit,
- Menaxhimi i Fondit për BRE përmes Operatorit të Tregut
- Lidhja e Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë (MBE) përmes Operatorit të Tregut

KEDS

- Kycja në Rrjetin e Distribucionit.

Në disa raste, para ndërtimit, nevojiten disa leje ndërtimi, varësisht nga lloji dhe lokacioni i impianteve të BRE-ve:

Ministria e Infrastrukturës

- Leja për Kycjen në infrastrukturën ekzistuese rrugore.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

- Lejet në rast të zonës së interesit të posaçëm apo zonës arkeologjike.

c) Mospërputhjet eventuale mes Ligjit nr. 03/L-185 për Rregullatorin e Energjisë, Ligjit nr. 04/L-144 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, si dhe Ligjit nr. 04/L-147 për Ujërat, do të analizohen dhe ndryshohen në bashkëpunim me autoritetet e përfshira.

Aktualisht, e drejta për shfrytëzimin e tokës dhe pyjeve mund të jepen për periudha deri në 5 vjet, gjë që nuk përbën garanci të mjaftueshme për investitorë, megjithatë, këto dispozita do të harmonizohen me dispozitat e Ligjit për Rregullatorin e Energjisë. Lejet për shfrytëzimin e ujërave jepen për periudhë 40-vjeçare.

Ekzistojnë probleme në nivel të autoriteteve lokale, në të cilat komunat nënshkruajnë Memorandume Mirëkuptimi me dy investitorëve mbi përdorimin e tokës, derisa sipas Ligjit nr. 04/L-147 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, kjo kompetencë mbahet nga Kuvendi Komunal. Në rastet e tilla, problemi i pajtueshmërisë ligjore në nivel autoritetesh lokale duhet shmangur.

Komunat duhet të kenë plane urbane dhe rregulluese (me detaje mbi kushtet e ndërtimit për lokacionet e vogla) si dhe nëse kërkesa nga investitori është në përputhje me atë plan, komunat lejojnë ndërtimin. Edhe pse shumica e komunave kanë plane urbane, mikro-planifikimi ende mungon në masë të madhe. Periudha e përgjigjes është caktuar në 30 ditë, si dhe nëse komuna nuk përgjigjet brenda atij afati, investitori lejohet të fillojë ndërtimin sikur të ishte dhënë leja e ndërtimit. Synimi i kësaj dispozite të ligjit ka qenë zvogëlimi i kohës dhe korrupsionit në sektor, por pasi që komunat nuk kanë kapacitete, këto dispozita mund të bëhen kundër-produktive.

d) Zyra e Rregullatorit të Energjisë është përgjegjëse për lëshimin e autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese. Ndërmjet Autorizimit Preliminar dhe Autorizimit (final) nga ZRRE-ja, procedura përfshin institucionet tjera të lartpërmendura (pika b) shtetërore e lokale. Pas lëshimit të autorizimit, mund të fillojë ndërtimi i impiantit.

Koordinimi më i mirë ndërmjet institucioneve të niveleve të ndryshme për projektet BRE do të arrihet përmes harmonizimit të ligjeve dhe procedurave përkatëse, siç ndodh me funksionimin e One Stop Shop-eve (OSS). Krijimi i OSS-ve është arritur me Rregulloren nr. 05/2018 për One Stop Shop për burimet e ripërtërishme të energjisë. OSS-të do të kontribuojnë në koordinimin e harmonizimin mes të gjitha autoriteteve përgjegjëse, ashtu që të paraqitet si proces koheziv.

e) Përkrahja për aplikuesit për autorizime, certifikim e licencim ofrohet tek faqja e internetit e ZRRE-së. Faqja e internetit e ZRRE-së ofron informata për aplikues dhe për autorizimet paraprake të nxjerra dhe autorizimet finale për projektet e energjisë nga BRE-të.

f) Koordinimi horizontal ndërmjet organeve të ndryshme qeveritare/administrative lidhur me procedurën e zhvillimit të projekteve të energjisë nga BRE bëhet si në vijim:

Procedura e dhënies së autorizimit fillohet me dorëzimin e aplikimit me dëshmitë dhe dokumentacionin e nevojshëm. ZRRE-ja është përgjegjëse për shqyrtimin fillestar të aplikimit dhe komunikimin me aplikuesin deri në kompletimin e dëshmimeve dhe dokumentacionit. Pas kësaj, Grupi Punues i ZRRE-së shqyrton aplikacionin dhe bën vlerësimin përfundimtar. Kur Grupi Punues konsideron aplikacionin e plotë, ai paraqitet në mbledhjen vijuese të Bordit për vendim. I njëjti proces vlen për autorizimin e parë preliminar, si dhe për autorizimin përfundimtar.

Për secilin projekt, hapi i parë përfshin aplikimin në MMPH për leje mjedisore. Procedura për shqyrtimin dhe përgjigjen ndaj aplikimeve të tilla përbën 70 ditë nga data e aplikimit.

Pas ndërtimit të impiantit, varësisht nga kapaciteti, subjekti juridik aplikon në MMPH për të marrë Lejen Mjedisore, si dhe për kapacitete më të mëdha, Leje të Integruar Mjedisore.

Sa i përket shfrytëzimit të burimeve ujore, Ligji i ri është miratuar dhe ka zëvendësuar Lejen Ujore me një procedurë autorizimi me tre hapa. Në hapin e parë pas dhënies së autorizimit preliminar nga ZRRE-ja, investitori aplikon për kushtet ujore, të cilat përshkruajnë llojet e dokumenteve që nevojiten për hapin vijues.

Sapo të jetë gati dokumentacioni, si dhe pak para marrjes së lejes së ndërtimit, investitori aplikon për marrjen e lejeve për shfrytëzim të ujit. Pas ndërtimit të hidrocentraleve, si dhe marrjes së lejes për shfrytëzim të ujit, leja mund të mbulojë periudha deri në 40 vjet për qëllime të gjenerimit të energjisë (sipas Udhëzimit Administrativ për administrimin dhe menaxhimin e resurseve ujore në periudhën e vlefshmërisë së lejes ujore).

ZRRE-ja zakonisht nxjerr vendimet për fazën e autorizimit brenda 3 muajsh, por, ka raste kur ato vendime nxirren në afate më të shkurtra - që në mbledhjen vijuese të Bordit.

Autorizimi preliminar ka afat vlefshmërie prej dy vitesh, si dhe gjatë asaj kohe, të gjitha lejet e domosdoshme për autorizim duhet të sigurohen. Në praktikë është vërtetuar që edhe 18 muaj mjaftojnë për këtë sipërmarrje.

Autorizimet Preliminare të lëshuara nga ZRRE-ja konfirmojnë që investitori përmbush kriteret e kualifikimit financiar dhe teknik, si dhe që ka stafin e duhur për të zhvilluar, ndërtuar e menaxhuar impiantin gjenerues (impiantin BRE).

Autorizimet Finale të dhëna nga ZRRE hapin rrugën për fillimin e ndërtimit të impiantit, si dhe konfirmojnë që investitorit i janë dhënë të gjitha kontratat dhe lejet e nevojshme (shfrytëzimi i tokës, shfrytëzimi i ujit, kycja në rrjet, leja mjedisore, leja ndërtimore, etj.) që kërkohen për këto raste.

Informatat mbi procedurat dhe hapat për zhvillimin e impianteve me BRE merren nga ZRRE-ja, megjithatë, ZRRE nuk mund të konsiderohet si one-stop-shop për përkrahjen e investitorëve.

Që prej vitit 2010, Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) aplikon Rregullin për Procedurën e Autorizimit të ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese (nga BRE). Ky rregull është ndryshuar e plotësuar në prill të vitit 2017, si dhe vlen për të gjitha teknologjitë BRE. Afati kohor për kompletimin e projekteve BRE është i njëjtë me të gjitha teknologjitë tjera. Periudha për ndërtimin e gjeneratorit me BRE është 2 vjet, si dhe mund të zgjatet për një vit më shumë. Në raste të jashtëzakonshme, periudha për ndërtim mund të zgjatet për 12 muaj plotësues. Rregulli është i ndarë në dy faza. Autorizimi Preliminar dhe Autorizimi Final.

Afatet kohore përcaktohen nga Rregulli, si dhe janë si vijon:

- Pasi ZRRE të marrë aplikimin e regjistruar, e shqyrton dhe nëse nuk është i plotë, afati i kompletimit është 60 ditë.
- Kur ZRRE e konsideron aplikacionin të plotë, duhet të nxjerrë vendim brenda 90 ditësh, si dhe të lëshojë Vendimin për Autorizimin Preliminar.
- Brenda 1 viti + 6 muajsh zgjatjeje, aplikuesi duhet të sjellë dëshmi për të marrë Autorizimin Final. Ka mundësi që investitori të aplikojë drejtpërdrejt për Autorizimin Final, por kjo ka ndodhur vetëm një herë deri tani.

Nuk ka autorizim (leje) automatike. Procesi duhet të shkojë siç është përshkruar më lart (dy faza) si dhe ka edhe hyrje automatike në skemën mbështetëse, si dhe kjo thuhet (përcaktohet) me Vendimin për Autorizimin Preliminar.

g) Në lidhje me specifikat e ndryshme teknologjike për implementimin e projekteve në sferën e BRE-ve, hapat ndërmjet autorizimit preliminar dhe atij final dallojnë nga lloji i teknologjisë së përdorur, kapaciteti i impiantit dhe lokacioni në të cilin do të zhvillohet projekti. Një shembull i hapave dhe procedurave që duhen ndjekur gjendet në procedurat që ndiqen në projekte që përfshijnë drutë e zjarrit dhe projektet që përdorin ujë.

h) në lidhje me procedurat specifike, nuk aplikohen procedura të tilla për stabilimentet e projekteve të vogla dhe gjenerimin e decentralizuar të energjisë nga BRE-të (panelet solare në ndërtesa apo bojlerët me biomasë në ndërtesa).

Udhëzimi Administrativ për shfrytëzimin dhe mbështetjen e gjenerimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme (nr. 06/2017) parasheh që projektet me kapaciteti deri në 100 kW i nënshtrohen procedurës së thjeshtë të autorizimit që miratohet nga Rregullatori dhe institucionet tjera relevante që merren me lëshimin e lejeve.

i) tarifat që i përkasin apikimit për autorizim/licencë/leje për instalimin e kapaciteteve të reja të gjenerimit me Bre publikohen në faqen e internetit të ZRRE-së. Tarifat e tilla lidhen me shpenzimet administrative të dhënies së atyre lejeve.

j) Aktualisht nuk ofrohen udhëzime zyrtare për organet lokale dhe rajonale administrative për planifikimin, projektimin, ndërtimin dhe renovimin e zonave industriale dhe banesore për instalimin e pajisjeve dhe sistemeve që përdorin burime të ripërtërishme të energjisë në energji elektrike dhe ngrohje e ftohje, duke përfshirë ngrohjen dhe ftohjen qendrore. Në këtë aspekt, mbështetja për organet lokale dhe rajonale pritet të ofrohet përmes institucioneve të themeluara rishtas, si zyrat komunale/rajonale të energjisë.

k) Zyrtarët përgjegjës të ZRRE-së që merren me procedurat e lidhura me autorizimin, certifikimin dhe licencimin e instalimit të pajisjeve që përdorin burime të ripërtërishme të energjisë përfitojnë trajnime të kohëpaskohshme që ofrohen në këto çështje. Këta zyrtarë kanë kualifikime të larta universitare në këto sfera.

l) Për të përmirësuar klimën e investimeve për projektet BRE, një grup ndërministror i udhëhequr nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik është pajtuar të krijojë një One-Stop-Shop (OSS) për BRE. Krijimi i OSS-ve është arritur me Rregulloren nr. 05/2018 për One Stop Shop për burimet e ripërtërishme të energjisë. Sipas përshkrimit në udhëzim, OSS do të veprojë si 'zyrë e informimit dhe koordinimit për t'i dhënë aplikuesve potencialë dhe palëve të interesuara informata të azhurnuara e të qarta mbi mënyrën e aplikimit, kriteret e aplikimit, afatet kohore, etj. Koordinimi harmonizohet mes të gjitha autoriteteve ashtu që të paraqitet si proces koheziv.

Për më tepër, OSS-ja do të lehtësojë bashkërendimin me institucionet përgjegjëse për projektet e energjisë së ripërtërishme, ashtu që të harmonizojë dhe lehtësojë procedurat administrative për lëshimin e lejeve përkatëse në rastin që ato identifikohen si pengesa për investitorët si palë, ose për palën që ka marrë lejen e autorizimit. Përfundimisht, OSS ka për obligim të ngrejë çështjet e mundshme që bllokojnë zhvillimin e projekteve BRE në nivel ministrash, përmes ministrit, në rast se pengesat eventuale të identifikuar gjatë procesit të lëshimit të lejeve të autorizimit apo lejeve të tjera nuk arrijnë të zgjidhen përmes negociatave me personelin relevant të institucionit përgjegjës. OSS-ja pritet të funksionalizohet më 2018.

4.2.2. Specifikimet teknike (neni 13(2) i Direktivës 2009/28/EC)

Specifikimet teknike që duhen plotësuar nga pajisjet dhe sistemet e energjisë së ripërtërishme për të përfituar nga skemat mbështetëse janë paraparë me Udhëzimin Administrativ për shfrytëzimin dhe mbështetjen e gjenerimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme (nr. 06/2017).

Posaçërisht, efikasiteti minimal i pajisjeve dhe sistemeve për prodhimin e energjisë termike nga biomasa është 85% për aplikim në sektorin **amvisnor** dhe atë **komercial**, si dhe 70% për aplikim në sektorin industrial. Për më tepër, impiantet që përdorin energjinë aerotermike, gjeotermike dhe hidrotermike përmes shfrytëzimit të pompave termike, duhet të përmbushin kriteret minimale të eko-etiketave për pompat termike-elektrike, me gaz apo me absorbim teknik. Në fund, impiantet termike me energji diellore duhet të kenë pajisje e sisteme që janë të certifikuara sipas standardeve evropiane, edhe etiketat ekologjike, etiketat energjetike, si dhe sistemet tjera referente.

4.2.3. Ndërtesat (neni 13(3) i Direktivës 2009/28/EC)

a) Në lidhje me nenin që ka të bëjë me rritjen e pjesës së energjisë nga burimet e ripërtërishme në sektorin ndërtimor, legjislacioni në vijim rregullon disa aspekte të tij:

- Ligji nr. 04/L-110 për Ndërtimin (GZ/Nr. 18/03 korrik 2013).
- Ligji nr. 2011/04-L-016 për Eficiencën e Energjisë (GZ/. Nr 6 / 22 Korrik 2011).
- Rregullorja teknike për kursimet e energjisë teknike dhe mbrojtjen termike në ndërtesa, nr. 03/2009.
- Rregullorja nr. 01/2012 për themelimin dhe funksionimin e Komisionit për Certifikimin e Auditorëve dhe Menaxherëve të Energjisë.
- Kodi Ndërtimor i Republikës së Kosovës.
- Ligji nr. 05/L-101 për performancën energjetike të ndërtesave.

b) Institucioni përgjegjës për zbatimin e legjislacionit për shfrytëzimin e BRE-ve në ndërtesa është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH).

c) Transpozimi i Direktivës 2010/31/EC për Performancën Energjetike të Ndërtesave (EPBD) është bërë përmes Ligjit për Ndërtim dhe Kodit Ndërtimor.

d) Nuk ka masa ekzistuese apo të planifikuara në nivel lokal/rajonale mbi shfrytëzimin e energjisë nga BRE në ndërtesa. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor duhet të hartojë rregulloret e nevojshme për të inkurajuar organet lokale dhe rajonale që të përfshijnë ngrohjen dhe ftohjen nga burimet e ripërtërishme të energjisë në planifikimin e infrastrukturës së qytetit, si dhe të përfshijnë kriteret minimale të integritit të BRE-ve në planifikimin e infrastrukturës.

e) Rritja e projektuar e shfrytëzimit të energjisë së ripërtërishme në ndërtesa deri më 2020, në sektorin publik dhe në atë privat, si dhe të ndara sipas viteve përkatëse, është prezantuar në Tabelën 11 më poshtë. Të dhënat ofrohen në baza vjetore. (Konsumi i burimeve të ripërtërishme të energjisë në ngrohje, ftohje dhe energji elektrike duhen përfshirë gjithashtu).

Tabela 11: Pjesëmarrja e vlerësuar e energjisë nga burimet e ripërtërishme në sektorin ndërtimor.

(%)	2009	2010	2015	2020
Banesore	48.0%	47.7%	51.5%	60.3%
Komerciale	5.8%	6.2%	6.0%	12.7%
Gjithsej	39.7%	39.6%	40.7%	49.0%

Nuk janë caktuar nivele minimale të shfrytëzimit të energjisë së ripërtërishme në ndërtesa të reja dhe të renovuara. Si alternativë, sistemet efiçente të energjisë duhet të përdorin energjinë e ripërtërishme në sistemet e decentralizuara të furnizimit të energjisë në ndërtesa të reja.

f) Harmonizimi dhe implementimi i EPBD-së do të nxisë përgatitjen e planeve specifike për sigurimin e rolit shembullor të ndërtesave publike në nivel shtetëror, rajonal e lokal, duke përdorur instalimet e energjisë së ripërtërishme ose duke u bërë ndërtesa me zero energji.

g) Teknologjitë e energjisë së ripërtërishme efiçente në energji planifikohen të promovohen në pajtim me skemën mbështetëse për energjinë e ngrohjes nga BRE-të, përcaktuar me Udhëzimin Administrativ për shfrytëzimin dhe mbështetjen e gjenerimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme (nr. 06/2017).

4.2.4. Dispozitat e informimit (nenet 14(1), 14(2) dhe 14(4) të Direktivës 2009/28/EC)

a) Nuk ka dispozita të shprehura në legjislacionin ekzistues në lidhje me kriteret e nenit 14 të Direktivës 2009/28/EC.

b) Institucioni përgjegjës për shpërndarjen e informatave në nivel shtetëror është MZHE-ja. Nuk ka trupa të tillë në nivel lokal apo rajonal.

c) Masat ekzistuese dhe të planifikuara në nivel rajonal dhe lokal për ofrimin e informatave përfshijnë fushatat e vetëdijesimit publik për EE dhe BRE. Këto fushata janë zbatuar dhe vazhdojnë të zbatohen me anë të TV-spotëve, konkurseve shkollore, fletëpalosjeve, billbordëve, punëtorive, trajnimeve, broshurave informuese, si dhe radio-reklamave.

d) Informatat e ofruara për palët relevante (konsumatorë, ndërtues, instalues, arkitektë, furnizues të pajisjeve dhe mjeteve relevante) në lidhje me masat mbështetëse për shfrytëzimin e energjisë nga burimet e ripërtërishme (energji elektrike, ngrohje, ftohje e transport) shpërndahen përmes: faqes së MZHE-së, fletëpalosjeve, broshurave, raporteve të progresit nga MZHE, fushatave, kontraktorëve, etj. Aktivitete të ngjashme planifikohen edhe për të ardhmen.

e) Vetëdijesimi dhe programet e trajnimit për qytetarë mbi dobitë dhe praktikën e zhvillimit dhe shfrytëzimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme bëhen vazhdimisht. Fushatat e tilla parashihen edhe

për të ardhmen. të gjitha fushatat për promovim dhe informim mbi BRE-të planifikohen dhe zbatohen në bashkëpunim me zyrtarët e nivelit lokal.

4.2.5. Certifikimi i instaluesve (neni 14(3) i Direktivës 2009/28/EC)

Certifikimi i instaluesve sipas parimeve të përshkuara me Shtojcën IV të Direktivës 2009/28/EC është vendosur me Udhëzimi Administrativ për shfrytëzimin dhe mbështetjen e gjenerimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme (nr. 06/2017). Neni 12 parasheh detyrimin e certifikimit të instaluesve të pajisjeve që shfrytëzojnë burime të ripërtërishme të energjisë, neni 13 specifikon autorizimin e institucioneve trajnuese, nenet 14 dhe 15 parashohin detajet e programeve të trajnimit dhe pjesëmarrjes në to, si dhe neni 16 vendos obligimin e certifikimit.

4.2.6. Zhvillimi i infrastrukturës së energjisë elektrike (neni 16(1), si dhe Neni 16(3) deri në (6) të Direktivës 2009/28/EC)

a) Legjislacioni kryesor që lidhet me rrjetet e energjisë si dhe operimin e rrjeteve është:

- Ligji nr. 05/L-081 për Energjinë (GZ/Nr. 24 / 13 Korrik 2015).
- Ligji nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë (GZ/Nr. 25 / 14 Korrik 2016).
- Ligji nr. 05/L-085 për Energjinë elektrike (GZ/Nr. 26 / 21 Korrik 2016).
- Rregulli për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja nga burimet e ripërtërishme të energjisë, miratuar në prill të vitit 2017 (ZRRE).
- Rregulli për licencimin e veprimtarive të energjisë në Kosovë, miratuar në mars të vitit 2017 (ZRRE).
- Rregulli për të ardhurat maksimale të lejuara të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Operatorit të Tregut (Rregulli për të ardhurat e OST/OT), miratuar në mars të vitit 2017 (ZRRE).
- Rregulli për të ardhurat maksimale të lejuara të Operatorit të Sistemit të Distribucionit (Rregulli për të ardhurat e OSD-së), miratuar në mars të vitit 2017 (ZRRE).
- Rregulli për Kushtet e përgjithshme të furnizimit të energjisë, miratuar në prill 2017 (ZRRE).
- Kodi i Rrjetit.
- Kodi i Rrjetit - Kodi për centralet gjeneruese me erë.
- Metodologjia e Tarifave të Kyçjes në Transmision/ KOSTT.
- Procedurat për Kyçje në rrjetin e Transmisionit / KOSTT
- Metodologjia e Tarifave të Kyçjes në Distribucion/ KEDS.
- Rregullat teknike për kyçje.
- Kodi i Njehsimit
- Kodi i Pajisjeve Elektrike.
- Kodi i Standardeve Elektrike.
- Kodi i praktikave për qasje në tokë dhe hapësira.
- Kodi i Distribucionit.
- Kodi i Njehsimit OSSH

b) Nga persektiva e integritetit të energjisë së prodhuar nga burimet e ripërtërishme të energjisë në planet zhvillimore të rrjetit të transmisionit dhe atij të shpërndarjes, KOSTT përgatit këto dokumente të planifikimit afatgjatë që rishikohen çdo vit dhe i dorëzohen ZRRE-së për miratim:

- Plani i Zhvillimit të Transmisionit, për 10 vjet.
- Plani i Përshtatshmërisë së Gjenerimit, për 10 vjet.
- Bilanci Afatgjatë i Energjisë Elektrike, për 10 vjet.
- Planet investuese për shpërndarje, për 3 vitet e ardhshme.

Këto dokumente marrin parasysh integrimin e energjisë së prodhuar nga burimet e ripërtërishme të energjisë në rrjet. Të gjitha dokumentet publikohen në faqet zyrtare të internetit.

c) Rrjeti i energjisë elektrike është në zhvillim të vazhdueshëm sipas planeve zhvillimore. Planet gjithashtu përmbajnë dispozita për rritjen e përdorimit të veglave të teknologjisë informative, si SCADA/EMS nga KOSTT-i. Për momentin, nuk ka plane për stabilimente depozitimi.

Për momentin, nuk ka ndonjë veprimtari të lidhur me përdorimin e konceptit të Rrjetit të Mençur.

d) Në lidhje me kapacitetet e interkoneksionit me vendet fqinje, KOSTT-i ende nuk është anëtar i Rrjetit Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmisionit për Energji Elektrike ENTSO/E, si dhe për momentin, EMS (OST i Serbisë) alokon kapacitetet për interkonektorët e Kosovës. Ekzistojnë probleme për shkak të alokimeve të kapaciteteve interkonektuese, si dhe nuk ka kompensim për rrjedhat tranzit. Pritet që gjendja të diskutohet dhe të zgjidhet me implementimin e projekteve vijuese:

- Linja 400 kV me Malin e Zi.
- Linja 400 kV me Maqedoninë, Linja 220 kV me Shqipërinë.
- Linja 400 kV me Serbinë ende nuk konsiderohet si interkonektor.

Në bazë të PZHRRT-së, si dhe studimeve relevante për zhvillimin e sistemit të transmisionit, disa projekte tejet të rëndësishme janë paraparë, me ndikim të brendshëm e rajonal mbi sigurinë dhe besueshmërinë e sistemeve të transmisionit:

- Linja 400 kV Kosovë – Shqipëri, me kapacitet 1300 MVA.
- Linja 400 kV Kosovë – Maqedoni, me kapacitet 1300 MVA.

e) Sa i përket procedurës së autorizimit për infrastrukturën e rrjetit, gjendja aktuale dhe koha mesatare për marrjen e aprovimeve, gjendja është si vijon: Pas kryerjes së autorizimit preliminar tek ZRRE-ja, zhvilluesit e kapaciteteve të ardhme të energjisë së ripërtërishme aplikojnë ose tek operatori i rrjetit të transmisionit ose tek OSSH-ja, varësisht nga vlerësimi i tyre i mundësive të kyçjes.

Dokumenti i aplikimit përbëhet nga të gjitha të dhënat relevante të projektit që nevojiten për modelin kompjuterik, kohën e planifikuar të komisionimit, etj. Në bazë të atyre të dhënave, inxhinierët e planifikimit analizojnë ndikimin e projektit dhe propozojnë zgjidhjen më të mirë për kyçje. Procedurat (afatet kohore deri në lidhje të marrëveshjes për Kyçje) përshkruhen në Metodologjinë e Tarifave të Kyçjes.

Operatori i transmisionit, sistemi dhe Tregut i Kosovës (KOSTT) ka hartuar dy dokumente, që sigurojnë transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike nga BRE-të:

1. Metodologjia e Tarifave të Kyçjes në Transmision
2. Procedurat për Kyçje në rrjetin e Transmisionit

Këto dokumente rregullojnë vlerësimin e shpenzimeve të kycjes në rrjet që lidhen me kycjen e gjeneratorin (përfshirë BRE-të) në rrjetin e transmisionit. Gjithashtu, në versionin më të fundit të Ligjit për Energjinë Elektrike, janë hartuar të ashtuquajturat Dizajni i Tregut dhe Rregullat e Tregut nga KOSTT-i (sistemi i Transmisionit dhe operatori i Tregut) si dhe janë miratuar nga ZRRE-ja, duke i dhënë prioritet dispeçingut të BRE-ve.

Varësisht nga “Procedurat për Kycje në rrjetin e Transmisionit” si dhe “Metodologjisë së Tarifave të Kycjes në Transmision”, koha nga Aplikimi për Kycje e deri në nënshkrimin e Marrëveshjes për Kycje në Transmision është si vijon:

Dita 0

Aplikuesi dorëzon Aplikimin për Kycje tek rrjeti i transmisionit, bashkë me dëshminë e pagesës, përmes postës apo drejtpërdrejt në Zyrën e Arkivit në KOSTT (nëse aplikacioni dorëzohet me postë, numërimi i ditëve fillon kur KOSTT-i të pranojë aplikimin).

Ditët 1-30

KOSTT-i shqyrton dhe nxjerr konstatimin nëse kycja e planifikuar me Aplikimin e Kycjes është (apo nuk është) teknikisht dhe ekonomikisht e mundur, si dhe në pajtim me dispozitat e Kodit të Rrjetit, përmbush kushtet dhe nuk paraqet problem për operimin e sigurt të sistemit të transmisionit. KOSTT-i, në bazë të analizës dhe shqyrtimit, përgatit dhe i dorëzon Aplikuesit njoftimin e mundësisë së kycjes në Rrjetin e Transmisionit, ose pamundësinë e saj.

Ditët 31-90

KOSTT-i përgatit Ofertën e Kycjes, të cilën ia dërgon Aplikuesit, bashkë me projekt-Marrëveshjen për Kycje në Rrjetin e Transmisionit.

Ditët 91-120

Aplikuesi shqyrton Ofertën e Kycjes për rrjetin e transmisionit të dorëzuar nga KOSTT-i, të cilën pastaj mund ta nënshkruajë.

Ditët 121-150

Aplikuesi dhe KOSTT-i shqyrtojnë/negociojnë dhe nënshkruajnë Marrëveshjen për Kycje në Rrjetin e Transmisionit.

Varet nga ndërlikueshmëria e projektit, por afati maksimal për marrjen e aprovimit për kycje është 150 ditë. Rrjeti i transmisionit është mjaft i zhvilluar, si dhe sa i përket rrjedhës së energjisë, cilësisë së tensionit me kriter N-1, sigurisë së sistemit dhe besueshmërisë, mund të ofrojë kycje të kapaciteteve të konsiderueshme të BRE-ve në rrjetin e transmisionit. Në bazë të potencialit të BRE-ve, kycja më e mundshme e BRE-ve (zakonisht erës dhe HC-të) do të jetë në rrjetin 110 kV.

Në bazë të marrëveshjes tashmë të nënshkruar për kycje të HC-së dhe Projektit të Erës, kohëzgjatja nga data e aplikimit e deri në datën e marrëveshjes së nënshkruar mes KOSTT-it dhe aplikuesit është 90 ditë.

Disa impiante prodhuese të energjisë elektrike të ripërtërishme priten të integrohen së shpejti në tregun e energjisë elektrike. Të gjitha Palët e licencuara për gjenerimin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme i nënshtrohen Rregullave të Tregut.

Ndërtimi i kycjes në rrjet bëhet nga zhvilluesi, sipas dizajnit të miratuar nga operatori i sistemit. Pas ndërtimit të suksesshëm, mbikëqyrur nga operatori i sistemit, instalimi i kycjes në rrjet i dorëzohet

operatorit të sistemit për operim dhe mirëmbajtje. Përshtatjet teknike të rrjetit, të nevojshme për kyçje, bëhen sipas planit të zhvillimit të rrjetit, si dhe ekzekutohen para ndërtimit të gjeneratorit me BRE.

f) Bashkërendimi ndërmjet miratimit të infrastrukturës së rrjetit dhe procedurave tjera të planifikimit administrativ bëhet përmes ZRRE-së, pasi që ky subjekt nxjerr autorizimin preliminar të vlefshëm për dy vjet, si dhe miraton të gjitha rishikimet vjetore të planeve zhvillimore të rrjetit energjetik. Aprovimi i Aplikimit për kyçje pason autorizimin preliminar si dhe miratimi përfundimtar i ZRRE-së është i mundur vetëm pas miratimit të kyçjes.

g) Të drejtat e përparësisë së kyçjes apo kapaciteteve të rezervuara për instalimet e reja që prodhojnë energji elektrike nga burimet e ripërtërishme të energjisë bazohen në listën e aplikuesve të regjistruar në ZRRE dhe të dorëzuar nga operatori i rrjetit, në përputhje me planin e rrjetit dhe procedurat për BRE.

h) Nuk ka raste të instalimeve të ripërtërishme të gatshme për të hyrë në funksion, por që nuk janë lidhur për shkak të kufizimeve të rrjetit në aspektin e kapaciteteve.

i) Sa i përket ndarjes së shpenzimeve si dhe bartjes së përshtatjeve teknike të rrjetit që caktohen dhe publikohen nga operatori i sistemit të transmisionit dhe ai i distribucionit, rregullat janë përshkruar në Metodologjinë e Tarifave të Kyçjes, që miratohet nga ZRRE-ja, kështu që janë siguruar kriteret objektive, transparente e jo-diskriminuese. Rregullat janë në dispozicion në faqen e internetit të KOSTT-it.

j) Në bazë të Metodologjisë së Tarifave të Kyçjes, të gjitha shpenzimet e përshtatjes teknike dhe të kyçjes barten nga gjeneratorët, si dhe rregullat janë të njëjta për të gjitha llojet e gjeneratorëve. Metodologjia gjithashtu përmban ngarkesa për kyçjet e thella.

Ekzistojnë plane të ndryshimeve të mundshme të metodologjisë për kyçje në rrjetin e shpërndarjes.

k) Sipas Metodologjisë së Tarifave të Kyçjes, gjeneratorët e kyçur më pastaj do të ndajnë koston e kyçjes me gjeneratorët fillimisht të kyçur, në proporcion me kapacitetin e instaluar.

l) Operatorët e sistemit të transmisionit dhe distribucionit i japin gjeneratorëve të rinj informatat për shpenzime, kornizën e saktë të afateve për trajtimin e kërkesave të tyre, si dhe afatet indikative për kyçjen e tyre në rrjet, në mënyrën vijuese:

Trajtimi i kërkesave është përshkruar në Metodologjinë e Tarifave të Kyçjes, miratuar nga ZRRE.

OST (KOSTT) ofron projeksionin e detajuar të shpenzimeve për investitorët potencialë. Zakonisht 1-2 muaj pas kompletimit të aplikacionit, gjeneratori i interesuar merr informatën e përafërt të shpenzimeve të kyçjes.

OSSH (KEDS) nuk ofron informata të tilla eksplicite. Përfshirja e tyre kufizohet ngushtë tek dhënia e kushteve teknike për kyçje. Ata formojnë një komision që del në terren, shqyrton lokacionin e stabilimentit

të ri, si dhe përcakton pikën e kycjes, si dhe kushtet teknike për aprovimin e kycjes, në pajtim me rregullat standarde teknike.

4.2.7. Operimi i rrjetit elektrik (neni 16(2), si dhe Neni 16(7) dhe (8) të Direktivës 2009/28/EC)

Obligimet në lidhje me gjeneratorët me BRE rrjedhin nga Ligji nr. 05/L-081 për Energjinë, respektivisht neni 14.

a) Veçanërisht, në rastin e dispeçingut për energjinë e prodhuar elektrike, Operatori i Sistemit të Transmisionit, ose Operatori i Sistemit të Distribucionit, i japin përparësi energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtërishme të energjisë dhe nga ko-gjenerimi, duke respektuar kufizimet e vëna për qëllim të sigurisë së sistemit, sipas Kodit të Rrjetit, si dhe kodeve e rregullave të tjera.

b) Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Operatori i Sistemit të Distribucionit përpilojnë dhe publikojnë rregullat standarde mbi atë se kush bart shpenzimet e përcaktimeve teknike, si kycja në rrjet dhe përforcimet e rrjetit, të nevojshme për integrimin e prodhuesve të rinj të energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtërishme të energjisë në sistemin e interkonektuar. Rregullat e tilla duhen dorëzuar tek Rregullatori si dhe duhet të jenë në përputhje me Strategjinë, të bazuara në kritere objektive, transparente e jo-diskriminuese, duke marrë parasysh posaçërisht të gjitha kostot dhe përfitimet që lidhen me kycjen e këtyre prodhuesve në sistem.

c) Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Operatori i Sistemit të Distribucionit duhet t'i japin secilit prodhues të ri të energjisë elektrike që shfrytëzon burimet e ripërtërishme të energjisë apo ko-gjenerimin, e që dëshiron të kyçet në sistem, vlerësimin gjithëpërfshirës dhe të detajuar të kostove të lidhura me kycjen, për të cilin vlerësim operatori i sistemit mund të ngarkojë një tarifë që reflekton shpenzimet e tij të arsyeshme.

d) Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Operatori i Sistemit të Distribucionit duhet të hartojnë dhe publikojnë rregullat standarde që kanë të bëjnë me ndarjen e shpenzimeve të instalimeve të sistemit, si kycja në treg dhe përforcimet, ndërmjet të gjithë prodhuesve të energjisë elektrike që përfitojnë nga to. Rregullat e tilla duhen dorëzuar për miratim tek Rregullatori, si dhe duhet të jenë në përputhje me Strategjinë si dhe aktet tjera nënligjore.

e) Rregullatori siguron që tarifat e transmisionit dhe distribucionit për kycje dhe shfrytëzim të sistemit të transmisionit dhe distribucionit të mos diskriminojnë ndaj operatorit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme të energjisë, duke përfshirë veçanërisht operatorit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme të energjisë të prodhuara në rajone periferike si dhe me dendësi të ulët të popullsisë.

f) Me qëllim të minimizimit të reduktimit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme të energjisë, si dhe përcaktimin e masave të planifikuara për zvogëlimin e reduktimit të tillë nga impiantet me erë, do të kontraktohet një studim mbi penetrimin e kapaciteteve të erës. Përveç këtyre, sipas nevojës, mund të zhvillohet një model i gjenerimit të energjisë elektrike nga era.

g) ZRRE-ja nuk informohet mbi masat e planifikuara, si dhe nuk ka autoritet t'i monitorojë ato.

Megjithatë, ZRRE-ja ka autoritet të monitorojë se si bëhet qasja në rrjet, duke përfshirë vendimet operacionale si reduktimet.

h) Sa i përket integritit të stabilimenteve me BRE në rrjetin elektrik dhe obligimeve të gjeneratorëve të asaj energjie për pjesëmarrje në tregun elektrik, në Kosovë, modeli i tillë është ende model tranzicioni. Gjeneratorët BRE nuk marrin pjesë në treg gjatë kohëzgjatjes së MBE-ve të tyre, sipas skemës së tarifës nxitëse feed-in , pasi që Operatori i Tregut është i obliguar të blejë energjinë elektrike të gjeneruar nga BRE-të, si dhe ta shpërndajë atë tek të gjithë furnizuesit, në bazë të hises në treg. Operatori i tregut do të ngarkojë çmimin referent të tregut të përcaktuar nga Rregullatori për këtë energji. Po bëhen diskutime mbi atë nëse gjeneratorët me BRE, pas përfundimit të MBE-së së tyre sipas rregullores së tarifës hyrëse, do të marrin pjesë në treg apo do të fitojnë të drejtën e MBE-së vijuese me PS me kushte të tjera, duke marrë parasysh rekomandimet e politikës së SKE-së për futjen në funksion të tarifave Premium dhe ankandit.

i) Rregullat mbi tarifën e sistemit të transmisionit dhe atij të distribucionit janë përshkruar në Metodologjinë e Tarifave të Këqjes të miratuar nga ZRRE-ja, si dhe tarifën kalkulohen në pajtim me ato rregulla.

4.2.8. Integrimi i bio-gazit në rrjetin e gazit natyror (neni 16(7), si dhe Neni 16(9) e (10) të Direktivës 2009/28/EC)

Nuk ekziston infrastruktura e gazit në Kosovë, si dhe nuk ka ndonjë plan afatshkurtër për zhvillimin e rrjetit të distribucionit të gazit.

Megjithatë, Ligji nr. 05/L-082 për gazin natyror parasheh dispozita të caktuara që sigurojnë trajtimin jo-diskriminues për bio-gazin dhe gazin nga biomasa, gjegjësisht:

- Neni 34, për qasjen e palëve të treta në sistemin e transmisionit, depozitimit dhe shpërndarjes
- Neni 37 për qasjen e palëve të treta në sistemin e transmisionit
- Neni 38 për Rregullat e Rrjetit të transmisionit
- Neni 41 për Rregullat e Rrjetit të distribucionit

a) mos-diskriminimi i gazit të prodhuar nga burimet e ripërtërishme të energjisë përmes tarifave të transmisionit dhe distribucionit sigurohet me anë të kornizës ligjore, e cila ofron mundësi të mjaftueshme për integrimin e gazit nga burimet e ripërtërishme në rrjetin e gazit natyror. Përveç neneve si më lart, Ligji nr. 03/L133 për gazin natyror përmban edhe nenin që përcakton infrastrukturën e re (neni 36) që synon të ofrojë mënyrat për lehtësimin e investimeve në infrastrukturë të re, duke përfshirë zgjerimet e rrjetit, modifikimet dhe rritjen e kapacitetit.

b) Sa i përket vlerësimit të nevojave për infrastrukturë gazi si dhe zgjerimin e asaj infrastrukture, në rast se rrjeti i gazit vlerësohet adekuat apo kurdo që nevojitet, procesi përfshin një vlerësim të mundësive për integrimin e gazit nga burimet e ripërtërishme.

c) Rregullat teknike për kyçje në rrjetet e gazit natyror dhe tarifat përkatëse të kyçjes nuk janë përgatitur.

4.2.9. Zhvillimi i infrastrukturës për Ngrohje dhe ftohje qendrore (neni 16(11) i Direktivës 2009/28/EC)

Sistemet dhe infrastruktura (rrjeti) i ngrohjes qendrore nuk janë të zhvilluara në nivel të kënaqshëm, si dhe aktualisht, sistemet e NQ-së nuk përdorin energji të ripërtërishme.

Instrumenti për ndihmë në asocim (IPA II) 2014-2020 do të shpjerë drejt përmirësimit të furnizimit të ngrohjes qendrore në Prishtinë dhe Gjakovë, ashtu që të ulen humbjet e energjisë termike në sistemet e ngrohjes qendrore, duke kontribuar kështu në efikasitet më të lartë brenda sistemit, për të përmirësuar cilësinë e furnizimit të ngrohjes për konsumatorë, e për të zëvendësuar energjinë elektrike për ngrohjes, duke rritur performancën mjedisore me kalimin tek burimet e ripërtërishme të energjisë (biomasa) në Gjakovë.

Kosova ka miratuar edhe Strategjinë e saj të Ngrohjes Qendrore 2011-2018, ku adresohen posaçërisht edhe burimet e ripërtërishme të energjisë. Ajo specifikon që përdorimi i linjitet të lagësht dhe shfrytëzimi i paqëndrueshëm i druve të zjarrit për ngrohje duhet minimizuar. Shfrytëzimi i energjisë diellore, mbeturinave komunale dhe mbetjeve nga druri është opsioni më premtues i ngrohjes me bazë në BRE. Stimujt financiarë për këto përdorime janë paraparë me Strategjinë e Ngrohjes, por ende nuk ekzistojnë si të tilla.

Vendosja e kuotave mandatore për pjesën me BRE për furnizuesit e ngrohjes qendrore do të merret parasysh.

Implantet ko-gjeneruese, të cilat shfrytëzojnë burimet e ripërtërishme të energjisë me efikasitet të lartë, do të mund të përfitonin nga bonuset shtesë për prodhimin/përdorimin e ngrohjes nga ko-gjenerimi me BRE apo skemat e ngrohjes me BRE.

Mundësia e subvencionimit të zhvillimit të rrjeteve të NQ-së me BRE është marrë në konsideratë nga Udhëzimi Administrativ nr. 06/2017 për shfrytëzimin dhe përkrahjen e BRE-ve, i cili përfshin skemën mbështetëse për implantet që përdorin burime të ripërtërishme për prodhimin e energjisë termike (skema e ngrohjes me BRE).

4.2.10. Bio-karburantet dhe bio-lëngjet tjera - kriteret e qëndrueshmërisë dhe verifikimi i pajtueshmërisë (nenet 17 deri në 21 të Direktivës 2009/28/EC)

Politika e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është të nxisë shfrytëzimin e tokës për prodhimin e ushqimit njerëzor dhe shtazor, ashtu që të ulen varësia nga importet. Shfrytëzimi i tokës për prodhim energjie (të vjela energjetike, apo bimët për prodhimin e bio-karburanteve) nuk është prioritet, për shkak të faktit të cilësisë së tokës së braktisur bujqësore.

Kështu, Kosova nuk ka plane të menjëhershme për prodhimin e lëndëve të para bujqësore për prodhimin e bio-karburanteve dhe pyetjet vijuese mund të marrin vetëm përgjigje të pjesshme. Kriteret e qëndrueshmërisë dhe verifikimi i pajtueshmërisë do të implementohen për importet e bio-karburanteve dhe prodhimin e bio-karburanteve nga lëndët e para të importuara.

a) Sa i përket kritereve të qëndrueshmërisë për bio-karburante dhe bio-lëngje në nivelin shtetëror, Projektligji për tregun e naftës dhe produkteve të naftës në Kosovë merret me çështjet e bio-karburanteve në përgjithësi, ndërsa caqet për konsumin e bio-karburanteve në transport dhe kriteret e qëndrueshmërisë do të përcaktohen me Udhëzimin Administrativ për përdorimin e bio-karburanteve dhe bio-lëngjeve në transport.

b) Sa i përket ofrimit të përkrahjes financiare për bio-karburantet, sipas kritereve të qëndrueshmërisë të caktuar me nenin 17(2) deri (5) të Direktivës 2009/28/EC, Udhëzimi Administrativ për përdorimin e bio-karburanteve dhe bio-lëngjeve në transport do të vendosë një skemë të pajtueshmërisë me kriteret e qëndrueshmërisë për importin dhe prodhimin vendor.

c) MTI-ja është përgjegjëse për monitorimin e përmbushjes së kritereve. Organi i vlerësimit të kritereve të qëndrueshmërisë do të definohet përmes Udhëzimit Administrativ për përdorimin e bio-karburanteve dhe bio-lëngjeve në transport.

d) Sa i përket nenit 17(3, 4 dhe 5) të Direktivës 2009/28/EC, Statusi i zonave të mbrojtura bazohet tek Ligji për mbrojtjen e natyrës nr. 03/L-233 (GZ nr. 85/09 nëntor 2010). Autoriteti që monitoron tokën dhe ndryshimet në statusin e tokës është Instituti për Mbrojtjen e Natyrës në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Legjislacioni shtetëror për administrimin e tokës (regjistrimin) përbëhet nga Ligji nr. 04/L-013 për Kadastrin (GZ. Nr.13 / 1 shtator 2011). Ndryshimet në statusin e zonave tokësore që janë të mbrojtura si zona të bio-diversitetit, apo shpallja e tokës si vlerë e lartë e biodiversitetit apo zonë e mbrojtur, janë në kuadër të përgjegjësive të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Autoriteti kompetent shtetëror që monitoron regjistrin e tokave dhe ndryshimet në statusin e tokës është Agjencia Kadastrale e Kosovës.

e) Në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës nr. 03/L-233 (Kapitulli 2, neni 8) kategorizimi i zonave të mbrojtura bëhet sipas Unionit Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Natyrës (IUCN).

f) Procedurat për ndërrimin e statusit të tokës nga toka bujqësore në tokë për qëllime jo-bujqësore rregullohen me Ligjin nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor (GZ. Nr. 30/23 gusht 2013), Ligjin nr. 02/L-26 për Tokën bujqësore, si dhe Udhëzimin Administrativ nr. 10/2010 për plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzimit Administrativ nr. 41/2006 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, të datës 27 dhjetor 2006.

Në bazë të paragrafit 8.2 të nenit 8 të Ligjit nr. 02/L-26 për tokën bujqësore, "organi komunal përgjegjës për bujqësi obligohet të mbajë evidencë të tokës së papunuar, si dhe për destinimet e caktuara, si dhe regjistrin e tokave që janë ndërruar në destinim nga përdoruesi."

MBPZHR-ja aktualisht është duke hartuar një projekt për themelimin e regjistrit të tokave bujqësore.

g) Ligjet në fuqi në sektorin e mjedisit dhe bujqësisë nuk marrin në konsideratë praktikata e mira agro-mjedisore, si dhe kriteret tjera të pajtueshmërisë së përgjithshme (siç kërkohen me nenin 17(6) të Direktivës 2009/28/EC). Në trajtimin e kriterëve të lëndëve të para në Kosovë, harmonizimi i ligjeve përkatëse do të bëhet për të marrë në konsideratë praktikata e tilla agro-mjedisore.

4.3. Skemat mbështetëse të aplikuara në Kosovë për promovimin e shfrytëzimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme në energjinë elektrike

a) Skema kryesore e mbështetjes është skema e tarifave hyrëse, që është mekanizëm vullnetar për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtërishme të ujit, erës, biomasës dhe fotovoltaike. Projektet e BRE-ve me kapacitete brenda nivelit të caqeve të planifikuara bazohen në skemën e tarifës hyrëse, të cilat përcaktohen nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

b) ZRRE-ja harton skemën, identifikon aktorët në treg që implementojnë skemën, si dhe monitoron funksionimin dhe performancën e skemës në përmbushjen e trajtores indikative dhe caqeve për BRE.

c) Në bazë të Ligjit të ri për energjinë elektrike nr. 05/L-085, neni 8, prodhimi i energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme të energjisë dhe ko-gjenerimi:

1. Kompensimi, pagesa e energjisë së prodhuar nga burimet e energjisë së ripërtërishme bëhet sipas tarifave për kompensimin e prodhimit të energjisë elektrike nga këto burime të cilat i mbledh Operatori i Tregut nga furnizuesit e konsumatorëve fundorë, me përjashtim të sasisë për të cilën prodhuesit kanë lidhur kontratë për shitje, sipas dispozitave të këtij ligji.
2. Rregullatori duhet të realizojë aranzhime për të kompensuar shpenzimet shtesë, me të cilat përballen furnizuesit, për shkak të blerjes së energjisë elektrike, sipas kushteve të përcaktuara në këtë nen, përmes një takse specifike në shërbimet e operatorëve të sistemit, e cila u ngarkohet në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese të gjithë furnizuesve të lidhur në sistemin përkatës, në proporcion me energjinë e blerë të tyre nga burimet e energjisë së ripërtërishme.
3. Rregullatori, sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, harton metodologjinë për përcaktimin e tarifave që duhet të paguajnë furnizuesit, për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet

e energjisë së ripërtërishme. Kjo metodologji duhet të përfshijë dispozita për kompensimin e

furnizuesve, për koston shtesë për blerjen e energjisë elektrike, të prodhuar nga këto burime të energjisë.

Operatori i Tregut është përgjegjës për lidhjen e marrëveshjeve të shitblerjes për pjesën obligative të energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtërishme të energjisë dhe ko-gjenerimi, si dhe inkasimin e pagesave për mbështetjen e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme të energjisë dhe ko-gjenerimi, nga të gjithë furnizuesit, duke përfshirë furnizuesit me obligime të shërbimit publik.

Derisa tregu të ketë vetëm një furnizues, kompensimi, pagesa e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtërishme të energjisë bëhet tarifë kompensimi për prodhim të energjisë elektrike nga këto burime, që inkasohen nga furnizuesi, me përjashtim të sasisë për të cilat prodhuesit kanë lidhur kontratë për shitje, sipas dispozitave të këtij ligji.

Furnizuesi publik është i obliguar të blejë me prioritet të parë të gjithë energjinë elektrike të prodhuar me BRE, si dhe të pranuar në skemë.

d) Tarifa e unifikuar hyrëse ofrohet për 12 vjet, me përjashtim të hidro-energjisë, që parashihet për 10 vjet. Mbështetja vendoset sipas metodologjisë së ZRRE-së, në nivelin që siguron kthimin adekuat mbi kapital. Skema e tarifës hyrëse ka korigjime vjetore të tarifës sipas inflacionit, për secilën teknologji të BRE-ve. Tarifat nxitëse feed-in dallojnë sipas teknologjive, por të gjitha dispozitat tjera mbesin të pandryshuara për secilin lloj të teknologjisë.

e) Nëse tarifat rishikohen në të ardhmen, rishikimi nuk ndikon tek gjeneratorët që janë pranuar më parë në skemë, por vetëm gjeneratorët që mund të aplikojnë pas datës së rishikimit.

f) Nuk parashihen rishikime periodike të skemës; megjithatë, ZRRE-ja ka të drejtë të ndryshojë tarifat kurdo që është e domosdoshme.

Me rishikimin e skemës stimuluese të tarifës nxitëse feed-in për hidro-energji dhe energji të erës, më 2016, Zyra e Rregullatorit të Energjisë ka rritur tarifën nxitëse feed in për energjinë elektrike nga uji, nga shifra e mëhershme 63.3 në 67.47 Euro/MWh, derisa për energjinë e erës, afati për shitjen e energjisë është rritur nga 10 në 12 vjet. Afati 12-vjeçar i Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë vlen edhe për energjinë fotovoltaike, derisa për hidro-energjinë është 10 vjet.

g) Tarifat nxitëse feed-in tarifa dallojnë sipas teknologjive të ndryshme, si vijon: - Hidro energji (HC të vogla) 67.47 Euro/MWh; - energjia e erës: 85 Euro/MWh; - Energjia nga biomasa 71.3 Euro/MWh si dhe fotovoltaiket 136.4 Euro/MWh.

h) Në bazë të tarifës nxitëse feed-in, në pajtim me caqet e energjisë të BRE-ve deri më 2020, zhvillimi i kapaciteteve të reja vijuese të prodhimit të energjisë elektrike do të mbështeten:

- 37 GWh në bazë të energjisë fotovoltaike (30 MW),
- 350 GWh nga era (173,8 MW) dhe
- 706 GWh (124,1 MW) nga burimet hidrologjike.

i) Mbështetja përmes tarifës për prodhimin e energjisë elektrike nga BRE-të nuk kushtëzohet me ndonjë kriter të eficiencës së energjisë.

j) Skema ekzistuese e mbështetjes është filluar me Rregullin për mbështetjen e energjisë elektrike për të cilën është nxjerrë Certifikata e Origjinës dhe Procedurat e pranimin në skemën e mbështetjes, miratuar më 29.12.2010. Rregulli i rishikuar i Skemës Mbështetëse, që është miratuar në mars të vitit 2017, siguron bazën ligjore dhe hapat që duhen ndërmarrë. ZRRE-ja informon ndërtuesin në kohën e aplikimit nëse ende ka kapacitet të mjaftueshëm të pambuluar me cak për të lejuar akomodimin e kapaciteteve të reja. Në këtë rast, pranimi në tarifën nxitëse feed in bëhet automatikisht. Pranimi merr efekt vetëm kur projekti të fillojë operimin komercial.

k) Tarifa nxitëse feed-in është funksionale për disa teknologji.

l) Skema ekzistuese e mbështetjes është filluar me Rregullin për mbështetjen e energjisë elektrike për të cilën është nxjerrë Certifikata e Origjinës dhe Procedurat e pranimit në skemën e mbështetjes, miratuar më 29.12.2010.

m) neni 4 i Rregullit për skemën mbështetëse për gjeneratorët me burime të ripërtërishme të energjisë përcakton madhësinë maksimale të një projekti të vetëm (impianti) që kualifikohet për skemë, si vijon:

- 3 MW për FV,
- 14 MW për biomasë,
- 35 MW për erë, si dhe
- 10 MW për hidro-energji.

Secili impiant që tejkalon kufijtë e tillë nuk konsiderohet si i kualifikueshëm për skemën mbështetëse.

n) Aktualisht, tarifa nxitëse feed-in është e vetmja skemë mbështetëse që ofron stimuj financiarë për të arritur caqet e energjisë nga BRE-të. Kushtet për të marrë këtë mbështetje përjashtojnë llojet tjera të stimujve financiarë nga shfrytëzimi i njëkohshëm për projektin në fjalë.

o) Aktualisht, nuk ka skema mbështetëse lokale/rajonale të prodhimit të energjisë nga BRE-të. Po të hartoheshin skema të tilla, MZHE-ja do ta shihte këtë si përkrahje të mirëpritur për nxitjen e zhvillimit të BRE-ve.

Përveç tarifës nxitëse feed-in, skema e granteve për bujq e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) është vendosur në programin vjetor të Zhvillimit Rural. Bujqit - pas implementimit të suksesshëm - rimbursohen me 50% të shumës totale të kostos së investimit me këtë skemë.

Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) ka hartuar dhe miratuar Rregullin për Garancitë e Prejardhjes për energjinë e prodhuar nga BRE-të, djegien e mbeturinave dhe impiantet e kombinuara ngrohje dhe energji, që ka hyrë në fuqi më 29 dhjetor 2010. Korniza për garancitë e origjinës do të zhvillohet e zbatohet më tutje me programin e përkrahur nga BE-ja, me datë përfundimtare të implementimit më 2019.

Ligji për energjinë elektrike nr. 05/L-085, miratuar së voni nga Parlamenti, merrret me Certifikatat e Origjinës për ER-në dhe ko-gjenerimin (neni 8 i Ligjit për energjinë elektrike).

Energjia që certifikohet me prejardhje të BR-ve kualifikohet për dispeçing prioritar sipas kushteve të përcaktuara me Kodin e Rrjetit dhe Rregullat e Tregut. OST dhe OSSH janë të obliguar t'i japin përparësi energjisë elektrike të prodhuar nga centralet me ER dhe ko-gjenerimit.

Furnizuesit me energji elektrike janë të obliguar të blejnë të gjithë sasinë e energjisë elektrike nga BRE-së të prodhuar me tarifa të rregulluara, përcaktuar nga ZRRE-ja përmes një metodologjie që merr parasysh kompensimin për furnizuesin publik për koston plotësuese të blerjes së energjisë elektrike nga BR-të. ZRRE-ja ka miratuar Rregullin për themelimin e sistemit të certifikatave të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga BR-të, djegien e mbeturinave dhe impiantet e kombinuara ngrohje dhe energji, që ka

hyrë në fuqi më 29 dhjetor 2010. Regjistri i certifikatave ende nuk është funksional. Deri më sot, ZRRE-ja ende nuk ka marrë ndonjë aplikim për nxjerrjen e Certifikatës së origjinës.

Për aq sa skema e tarifave nxitëse feed-in për BRE, e cila i jep përparësi në dispeçing, cakton sasi të synuara të BRE-së, mungesa e sistemit të certifikatave të origjinës nuk përbën pengesë për shtrirjen e BR-ve. Megjithatë, pasi ato caqe të përmbushen, ose tarifa hyrëse nuk jep më rezultate, sistemi funksional i certifikatave të origjinës do të ishte mënyrë e rëndësishme e promovimit të BR-ve. Mungesa e sistemit të certifikatave të origjinës mund edhe të dëmtojë besimin e investitorëve që Kosova zbaton rregullat e Komunitetit të Energjisë, duke krijuar kështu barrierë të vogël.

Përveç kësaj, në të ardhmen, mundësia e zhvillimit të skemave vijuese duhet të merret parasysh:

- Shkurtime apo lirime doganore për pajisjet për BRE.
- Kreditë apo lirime nga tatimi në fitim për investime në BRE që sigurojnë punësim rajonal (brenda kompetencës së MF-së).
- Krijimi i linjave kreditore me kamata të ulëta për projektet BRE (përmes bashkëpunimit të pritur me bankat zhvillimore).
- Ankandet për hidrocentralet e vogla, panelet fotovoltaike, si dhe projektet me erë.

4.4. Skemat mbështetëse të aplikuara në Kosovë për promovimin e shfrytëzimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme në ngrohje dhe ftohje

a) Deri më sot, nuk ekziston ndonjë skemë mbështetëse për shfrytëzimin e energjisë nga burimet e ripërtërishme në ngrohje e ftohje.

Udhëzimi Administrativ për shfrytëzimin dhe mbështetjen e gjenerimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme (nr. 06/2017) propozon aplikimin e skemës mbështetëse edhe për energjinë termike nga BRE-të (ngrohje dhe ftohje).

Neni 10 parasheh që prodhuesit e energjisë termike nga impiantet që përdorin burime të ripërtërishme të energjisë kualifikohen për pranim në skemën mbështetëse si dhe kanë të drejtë të lidhin marrëveshje me furnizuesin publik për shitjen e energjisë termike me tarifa të rregulluara hyrëse ose pagesa premium, që aplikohet deri në nivelin e përmbushjes së caqeve për burimet e ripërtërishme të energjisë në mënyrën më efektive për koston. Rregullatori përcakton metodologjinë për vendosjen e tarifave të rregulluara për blerjen e energjisë termike nga burimet e ripërtërishme nga furnizuesi publik për centralet energjetike nga grupi 1 dhe 2 të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ. Tarifat hyrëse përcaktohen për kategoritë kryesore të burimeve të ripërtërishme të energjisë sipas paragrafit 1.1 dhe 1.2 të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ si dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ për caqet e energjisë nga burimet e ripërtërishme të energjisë.

Vendosja e skemave plotësuese do të merret parasysh në të ardhmen, duke përfshirë:

- Aplikimi i granteve investuese, apo pagesave të kapacitetit për ndërtimin e kapaciteteve të ngrohjes dhe ftohjes me BRE, me bio-masë, solare-termike, si dhe energjinë gjeotermike, me përcaktime specifike mbi teknologjitë dhe madhësitë e impianteve të tilla.
- Lirime apo zbritjet doganore dhe të TVSH-së për pajisjet BRE (nën juridiksionin e MF-së);
- Krijimi i linjave kreditore me kamata të ulëta për projektet BRE (përmes bashkëpunimit të pritur me bankat zhvillimore);

- Inkurajimi i bashkëpunimit me grupet e interesit për të siguruar shfrytëzim më të madh të energjisë nga biomasa, dielli dhe energjisë gjeotermike.

b) Deri më sot, nuk ekzistojnë skema mbështetëse për ko-gjenerimin nga BRE-të. Në rishikimin e sistemit të tarifave mbështetëse, aplikimi i bonusit plotësues propozohet për prodhimin/shfrytëzimin e ngrohjes dhe ftohjes në ko-gjenerim nga BRE-të, sipas UA-së për shfrytëzimin dhe promovimin e energjisë nga BRE-të.

c) Deri më sot, nuk ekzistojnë skema të tilla mbështetëse.

Prodhimi i energjisë së ngrohjes dhe shpërndarja e saj përmes rrjetit të NQ-së do të mbështeten nga bonuset plotësuese që aplikohen për prodhimin/shfrytëzimin e ngrohjes nga ko-gjenerimi me BRE, ose nga skemat e mbështetjes për energjinë e ngrohjes nga BRE-të në bazë të UA-së për shfrytëzimin dhe promovimin e energjisë nga BRE-të.

Përveç këtyre, kuota obligative e energjisë nga BRE-të për furnizuesin publik të energjisë nga BRE-të do të propozohen të mbështeten në pajtim me skemat mbështetëse për gjenerimin e ngrohjes nga BRE-të, në bazë të UA-së për shfrytëzimin dhe promovimin e energjisë nga BRE-të.

d) Deri më sot, nuk ekzistojnë skema mbështetëse për të inkurajuar shfrytëzimin e ngrohjes dhe ftohjes në masë të vogël nga BRE-të.

e) Deri më sot, nuk ekzistojnë skema mbështetëse për të inkurajuar shfrytëzimin e ngrohjes dhe ftohjes nga BRE-të në aplikimet industriale.

4.5. Skemat mbështetëse për promovimin e shfrytëzimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme në transport, të aplikuar nga Shtetet Anëtare, apo një grup Shtetesh Anëtare

Deri më sot, nuk ekziston ndonjë skemë mbështetëse për shfrytëzimin e burimeve të ripërtërishme në transport.

Masat kryesore të promovimit të shfrytëzimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme do të jetë kuota obligative për shfrytëzimin e bio-karburanteve në transport.

Përveç këtyre, në të ardhmen, do të konsiderohen dhe zhvillohen skemat vijuese:

- Lirimet nga taksa e akcizës për bio-lëndë që vihen në treg (brenda juridiksionit të MF-së)

Skema e kuotave obligative

a) Projektligji për tregun e naftës dhe produkteve të naftës në Kosovë merret me çështjet e bio-karburanteve në përgjithësi, ndërsa caqet për konsumin e bio-karburanteve në transport dhe kriteret e qëndrueshmërisë do të përcaktohen me Udhëzimin Administrativ për përdorimin e bio-karburanteve dhe bio-lëngjeve në transport.

Udhëzimi Administrativ në fjalë do të specifikojë caqet e përdorimit të bio-karburanteve për secilin vit, deri më 2020. Këto caqe do të jenë obligative për të gjithë furnizuesit e produkteve të naftës.

b) Udhëzimi Administrativ për përdorimin e bio-karburanteve dhe bio-lëngjeve në transport do të përmbajë caqet indikative për Bioetanol dhe Biodizel, por obligimi do të caktohet sipas përqindjes së bio-karburantit në karburantet totale të vëna në treg nga furnizuesi i caktuar i produkteve të naftës.

c) Udhëzimi Administrativ për përdorimin e bio-karburanteve dhe bio-lëngjeve në transport do të përmbajë obligimet konkrete për përdorimin e bio-karburanteve.

d) Obligimi do të caktohet për të gjithë furnizuesit (mundësisht edhe distributorët - rishitësit) e produkteve të naftës.

e) Ka edhe dispozita ndëshkuese në projektligjin për naftën dhe produktet e naftës në Kosovë.

f) Sipas Udhëzimit Administrativ 07/2012 për cilësinë e lëndëve djegëse të nxjerra nga nafta, të gjithë furnizuesit e naftës dhe produkteve të naftës duhet t'i dërgojnë raport Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë mbi sasinë e secilës lëndë që e fusin në treg.

g) Nuk parashihet ndonjë mekanizëm për modifikimin e caqeve, por sipas raporteve vjetore, MTI-ja posedon informata mbi zhvillimin e tregut. Pasi që caqet do të rregullohen me UA për përdorimin e bio-lëndëve në transport, UA-ja mund të ndryshohet sipas nevojës.

4.6. Masat specifike për promovimin e shfrytëzimit të energjisë nga biomasa

4.6.1. Furnizimi i biomasës: vendore dhe nga tregtia

Tabela 12: Furnizimi i biomasës më 2009

Sektori i prejardhjes		Sasia e burimit vendor ²⁰	Importuar		Eksportuar EU / Jo- BE	Sasia neto	Prodhimi primar i energjisë (ktoe)
			BE	Jo- BE			
A) Biomasa nga pylltaria ²¹ :	<i>Nga të cilat:</i>						
	(1) furnizimi direkt i biomasës drusore nga pyjet dhe tokat tjera pyjore për prodhim të energjisë	295008 (m3 të stivosur)		7000 (m3 të stivosur)		302008 (m3 të stivosur)	40.1 ktoe
	<i>Opsionale - nëse ka informata, mund të jepen më shumë detaje mbi sasinë e masës në këtë kategori:</i>						
	(a) Prerjet	242568					35.6 ktoe
	(b) Mbetjet nga prerjet (majat, degët, lëvore, cungje)	(m3 s.) 26220					2.25 ktoe
	(c) Mbetjet nga menaxhimi i peizazhit (biomasa drusore nga parqet, kopshtet, rreshtat e trungjeve, shkurret)	(m3 s.) 26220					2.25 ktoe
(d) Të tjera (defino)							
(2) furnizimi indirekt i biomasës drusore nga pyjet dhe tokat tjera pyjore për prodhim të energjisë							
<i>Opsionale - nëse ka informata, mund të jepen më shumë detaje</i>							
(a) Mbetjet nga sharra, puna me dru, industria e mobileve (lëvore, tallash)							
(b) Nus-produktet e pulpës dhe industria e letrës (lëngu i zi, vaji)							
(c) Karburanti nga druri i përpunuar							
(d) Druri i ricikluar pas konsumatorit (druri i ricikluar për gjenerim të							

²⁰Sasia e resursit në m³ për kategorinë A dhe nën-kategoritë e saj: si dhe në tonë, për kategoritë B dhe C si dhe nën-kategoritë e tyre.

²¹Biomasa nga pylltaria duhet të përfshijë edhe biomasën nga industrinë me bazë pyjore. Tek kategoria e biomasës nga pylltaria, lëndët e ngurta, si ashklat, peletet dhe briketet duhen përfshirë në nën-kategoritë përkatëse të origjinës.

Sektori i prejardhjes		Sasia e burimit vendor ²⁰	Importuar		Eksportuar	Sasia neto	Prodhimi primar i energjisë (ktoe)
			BE	Jo-BE	EU / Jo-BE		
	energjisë, mbetje drusore amvisnore) (e) Të tjera (defino)						
B) Biomasa nga bujqësia dhe peshkataria:	<i>Nga të cilat:</i>						
	(1) të vjela bujqësore dhe produkte peshkatore drejtpërdrejt të përdorura për prodhim të energjisë						
	<i>Opsionale - nëse ka informata, mund të jepen më shumë detaje</i>						
	(a) Kulturat ushqimore (drithëra, fara vaji, panxhari, misër silazh) (b) Plantacionet (c) Trungjet e shkurtra (d) Kultura të tjera energjetike (barishte) (e) Algat (f) Të tjera (defino)						
	(2) nus-produktet bujqësore/ mbetjet e përpunuara dhe nus-produktet e peshkatarisë për prodhim energjie						
<i>Opsionale - nëse ka informata, mund të jepen më shumë detaje</i>							
(a) kashta (b) plehu (c) yndyra shtazore (d) mishi dhe eshtrat (e) nus-produktet e koksit (përfshirë koxsin e farave dhe të vajit të ullirit për energji) (f) biomasa e frutave (përfshirë bërthamat, lëvozhgat) (g) nus-produktet e peshkatarisë							

Sektori i prejardhjes		Sasia e burimit vendor ²⁰	Importuar		Eksportuar	Sasia neto	Prodhimi primar i energjisë (ktoe)
			BE	Jo-BE	EU / Jo-BE		
	(h) copëzat nga vreshtat, ullinj të, trungjet frutore (i) të tjera (defino): mbetjet nga mullinj të e orizit dhe tjerret e pambukut						
C) Biomasa nga mbeturinat:	<i>Nga të cilat:</i>						
	(1) Pjesa e bio-degradueshme nga mbeturinat e ngurta komunale, duke përfshirë bio-mbeturinat (mbetjet e bio-degradueshme të kopshteve dhe parqeve, mbetjet ushqimore dhe të kuzhinës nga familjet, restorantet, hotelieret, si dhe lokalet shitëse, si dhe mbetjet e krahasueshme nga fabrikat e përpunimit ushqimor) si dhe gazi nga deponitë e mbeturinave						
	(2) Pjesa e bio-degradueshme nga mbeturinat industriale (përfshirë letrën, kartonin, paletat)						
	(3) Zgjyra e kanalizimit						

Tabela 13: Furnizimi i vlerësuar vendor i biomasës më 2015 dhe 2020.

Sektori i prejardhjes		2015		2020	
		Sasia e pritur e burimit vendor	Prodhimi primar i energjisë ²² (ktoe)	Sasia e pritur e burimit vendor	Prodhimi primar i energjisë

²² Të dhënat në kolonën "prodhimi primar i energjisë" i referohen energjisë finale brenda bio-lëndëve të prodhuara.

					ë ²⁰ (ktoe)
	(1) furnizimi direkt i biomasës drusore nga pyjet dhe tokat tjera pyjore për prodhim të energjisë	Sasia totale e drurit supozohe t të jetë 660574.6 2 m3 stivosur	80.6 ktoe	Sasia totale e drurit supozohet të jetë 689213.2 6 m3 stivosur	83.96 ktoe
	(2) furnizimi indirekt i biomasës drusore nga pyjet dhe tokat tjera pyjore për prodhim të energjisë				
B) Biomasa nga bujqësia dhe peshkataria :	(1) të vjela bujqësore dhe produkte peshkatore drejtpërdrejt të përdorura për prodhim të energjisë				
	(2) nus-produktet bujqësore/ mbetjet e përpunuara dhe nus-produktet e peshkatarisë për prodhim energjie				
C) Biomasa nga mbeturinat :	<i>Nga të cilat:</i> (1) Pjesa e bio-degradueshme nga mbeturinat e ngurta komunale, duke përfshirë bio-mbeturinat (mbetjet e bio-degradueshme të kopshteve dhe parqeve, mbetjet ushqimore dhe të kuzhinës nga familjet, restorantet, hotelieret, si dhe lokalet shitëse, si dhe mbetjet e krahasueshme nga fabrikat e përpunimit ushqimor) si dhe gazi nga deponitë e mbeturinave				
	(2) Pjesa e bio-degradueshme nga mbeturinat industriale (përfshirë letrën, kartonin, paletat)				
	(3) Zgjyra e kanalizimit				

Tabela 14: Shfrytëzimi aktual i tokës bujqësore për prodhimin e kulturave të dedikuara për energji në vitin 2009.

Toka bujqësore e përdorur për prodhim të dedikuar energjie	Sipërfaqja në ha
1. Toka e përdorur për trungje gjetherënëse (shelg, plep)	0

2. Toka e përdorur për kultura të tjera energjetike, si barishtat (bari red canary, switch, Miscanthus), sorghum	0
--	---

4.6.2. Masat për rritjen e disponueshmërisë së biomasës, duke marrë parasysh përdoruesit tjerë të biomasës (sektori i bujqësisë dhe të tjerë të bazuar në pyje)

- a) Nuk ka të dhëna në dispozicion mbi nivelin e degradimit të tokave bujqësore dhe pyjore. Parandalimi i prerjeve të paregjistruara mund të promovohet, bashkë me praktikën e qëndrueshme të krasitjes së pyjeve, duke marrë parasysh studimin rajonal të ngrohjes me bazë biomase ²³
- b) Nuk ka të dhëna në dispozicion mbi sipërfaqen e tokës së punueshme djerrë.
- c) Nuk janë propozuar ende masat për inkurajimin e shfrytëzimit të tokave të papunueshme, tokës së degraduar, etj., për qëllim të kultivimit të kulturave energjetike.
- d) Nuk planifikohet përdorimi i materialeve primare (si plehu shtazor) për qëllime energjie.
- e) Inkurajimi i prodhimit dhe përdorimit të biogazit shtyhet përpara përmes politikave shtetërore - tarifa hyrëse për biogazin.
- f) Sa i përket planifikimit të masave për përmirësimin e teknikave të menaxhimit të pyjeve, Strategjia e Zhvillimit të Pylltarisë 2010-2020 parasheh një projekt për avancimin e menaxhimit pyjor.

Ndikimi në sektorë të tjerë:

- a) për momentin, nuk ekziston ndonjë skemë e monitorimit për ndikimin e biomasës së përdorur në gjenerimin e energjisë në sektorin e bujqësisë dhe pylltarisë.
- b) Nuk ka informata në dispozicion mbi zhvillimet e pritura në sektorë të tjerë me bazë në bujqësi dhe pylltari, e që mund të kenë ndikim në shfrytëzimin për energji.

4.7. Shfrytëzimi i planifikuar i transferimeve statistikore ndërmjet Shteteve Anëtare dhe pjesëmarrja e planifikuar në projekte të përbashkëta me Shtetet tjera Anëtare dhe vendet e treta

Kosova ka përfshirë në legjislacionin e vet energjetik (Udhëzim qeveritar, 2013) një dispozitë për pjesëmarrje në transferimet statistikore dhe/ose skemat e përbashkëta të mbështetjes ndërmjet Palëve kontraktuese të Komunitetit të Energjisë. Ky legjislacion mund të aktivizohet për të arritur cakun prej 25% nëse prodhimi brenda vendit nuk mjafton. Skema do të mundësonte bashkëpunimin real me Palët tjera

²³ Shih <https://www.energy-community.org/news/Energy-Community-News/2018/02/07.html>

Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë. Dispozitat për ta bërë të njëjtën gjë me shtetet anëtare të BE-së, pasi Kosova të hyjë në BE, ende mbeten të implementohen.

Neni 17 i Udhëzimit Administrativ për shfrytëzimin dhe mbështetjen e gjenerimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme (nr. 06/2017) vendos kornizën për transferimet statistikore.

Kosova mund të lidhë marrëveshje me palët kontraktuese të Komunitetit të Energjisë në bazë të transferimeve statistikore për një sasi të caktuar energjie të prodhuar nga burimet e ripërtërishme për të arritur cakun obligativ prej 25% më 2020. Marrëveshja për transferimin statistikor mund të jetë vjetore dhe shumëvjeçare, ndërsa Sekretariati i Komunitetit të Energjisë duhet njoftuar për këtë jo më vonë se tre (3) muaj, pas vitit në të cilin është bërë efektivisht transferimi statistikor. Informata duhet të përmbajë sasinë dhe çmimin e energjisë së transferuar.

kalkulimi i sasisë së prodhuar nga burimet e ripërtërishme, sipas paragrafit 1 të këtij neni, ndërmjet palëve kontraktuese, duhet të jetë në pajtim me metodologjinë për përcaktimin e caqeve të energjisë nga burimet e ripërtërishme të energjisë dhe nuk duhet të ndikojë në përmbushjen e caqeve për burimet e ripërtërishme të energjisë të palëve të përfshira në transferimin statistikor. Specifikat e transferimeve statistikore përshkruhen në marrëveshjet mes palëve të këtij procesi.

Tabela 15: Prodhimi i vlerësuar i tepërt dhe/ose i mangët i energjisë së ripërtërishme, krahasuar me trajektoren indikative, që mund të transferohen në/nga Shtetet tjera Anëtare në Kosovë.

ktoe	2016	2017	2018	2019	2020
Suficiti i vlerësuar në dokumentin e prognozës	0	0	0	0	0
Suficiti i vlerësuar në PKVBRE	0	0	0	0	0
Deficiti i vlerësuar në dokumentin e prognozës	NA	NA	NA	NA	NA
Deficiti i vlerësuar në PKVBRE	142	142	107	74	0

5. VLERËSIMET

5.1. Kontributi total i pritur nga secila teknologji e energjisë së ripërtërishme për arritjen e caqeve obligative të vitit 2020 si dhe trajektorja indikative e përkohshme për pjesën e energjisë nga burimet e ripërtërishme në energji elektrike, ngrohje e ftohje, si dhe transport

Kontributi dhe trajektoret indikative të energjisë nga BRE-të janë paraqitur në Tabelat 16-19, si më poshtë.

Tabela 16: Potenciali i disponueshëm në Kosovë për secilën teknologji të energjisë së ripërtërishme në energji elektrike, për periudhën 2009-2014.

	2009		2010		2011		2012		2013		2014	
	MW	GWh	MW	GWh	MW	GWh	MW	GWh	MW	GWh	MW	GWh
<i>Hidro:</i>												
<1MW	0	0	2	0	3	8	3	8	3	14	3	7
1MW–10 MW	8	0	8	0	8	22	8	23	8	30	8	42
>10MW	32	120	32	156	32	74	32	65	32	99	32	102
<i>Prej të cilave pompim</i>												
Gjeotermik												
Diellor:												
<i>fotovoltaik</i>												
<i>Energji e koncentruar solare</i>												
Batica, vala, oqeani												
Era:												
<i>Në breg</i>			1.35	1	1.35	0	1.35	0	1.35	0	1.35	0
<i>Larg bregut</i>												
Biomasa:												
<i>ngurtë</i>												
<i>biogaz</i>												
<i>biol-lëngje²⁴</i>												
GJITHSEJ	40	120	43	157	44	104	44	96	44	143	44	151

²⁴ Duke marrë parasysh vetëm ato që janë në pajtim me kriteret e qëndrueshmërisë, shih nenin 5(1) të Direktivës 2009/28/EC, nën-paragrafi i fundit

Prej të cilave në ko- gjenerim												
-----------------------------------	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Tabela 17: Potenciali i disponueshëm në Kosovë për secilën teknologji të energjisë së ripërtërishme në energji elektrike, për periudhën 2015-2020.

	2015		2016		2017		2018		2019		2020	
	MW	GWh	MW	GWh	MW	GWh	MW	GWh	MW	GWh	MW	GWh
Hidro:												
<1MW	3	5	3	13	3	13	3	13	3.3	15	5.6	25
1MW-10 MW	8	31	38.3	171	38.3	171	69.4	310	100.1	447	111.7	499
>10MW	32	103	49.8	183	49.8	183	49.8	183	49.8	183	49.8	183
<i>Prej të cilave pompim</i>												
Gjeotermik												
Diellor:												
<i>fotovoltaik</i>			0.6	1	0.6	1	7	9	10	12	30	37
<i>Energji e koncentruar solare</i>												
Batica, vala, oqeani												
Era:												
<i>Në breg</i>	1.35	0	1.35	3	1.35	3	33.8	68	33.8	68	173.8	350
<i>Larg bregut</i>												
<i>Biomasa:</i>												
<i>ngurtë</i>												

<i>biogaz</i>												
<i>biol-lëngje</i> ²⁵												
GJITHSEJ	44	139	93	371	93	371	163	583	197	725	371	1093
Prej të cilave në ko-gjenerim												

Tabela 18: Potenciali i disponueshëm në Kosovë për secilën teknologji të energjisë së ripërtërishme në ngrohje-ftohje, për periudhën 2009-2020 (ktoe).

	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Gjeotermike (duke përjashtuar ngrohjen Gjeotermike me temperaturë të ulët në aplikime të pompës së ngrohjes)												
Diellore	0.2	0.2	0.2	0.3	0.3	0.3	0.3	0.3	0.3	1.3	2.2	4.2
Biomasa:												
<i>ngurtë</i>	224	226	231	236	236	240	251	251	251	260	268	283
<i>biogaz</i>												
<i>bio-lëngje</i> ²⁶												
Energji e ripërtërishme nga pompat e ngrohjes: - prej të cilave aero-termike - prej të cilave gjeotermike	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.2	0.4	0.9

²⁵ Duke marrë parasysh vetëm ato që janë në pajtim me kriteret e qëndrueshmërisë, shih nenin 5(1) të Direktivës 2009/28/EC, nën-paragrafi i fundit.

²⁶ Duke marrë parasysh vetëm ato që janë në pajtim me kriteret e qëndrueshmërisë, shih nenin 5(1) të Direktivës 2009/28/EC, nën-paragrafi i fundit.

- prej të cilave hidro-termike												
Gjithsej	224	226	231	236	236	240	251	251	251	262	271	288
Prej të cilave NQ ²⁷												
Nga të cilat biomasë në ekonomi familjare ²⁸	217	218	222	227	229	231	242	241	241	249	258	279

Tabela 19: Potenciali i disponueshëm në Kosovë për secilën teknologji të energjisë së ripërtërishme në transport, për periudhën 2009-2020 (ktoe).

	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Bioetanol/bio-ETBE	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0	1	6
Prej të cilave bio-lëndë neni 21(2) ²⁹	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Prej të cilave të importuara ³⁰	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0	1	6
Biodizel	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	18.5	33.7
Prej të cilave bio-lëndë neni 21(2)	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Prej të cilave të importuara	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0	18.5	33.76
Hidrogjen nga të ripërtërishmet	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0

²⁷ Ngrohja dhe/ose ftohja qendrore nga konsumi i përgjithshëm i ngrohjes dhe ftohjes së ripërtërishme (BRE-NQ).

²⁸ Nga i gjithë konsumi i përgjithshëm i ngrohjes dhe ftohjes së ripërtërishme, e gjithë sasia e bio-dizelit.

²⁹ Bio-lëndët që janë përfshirë tek neni 21(2) i Direktivës 2009/28/EC.

³⁰ Nga e gjithë sasia e bioetanol/bio-ETBE.

Energji elektrike e ripërtërishme	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
Prej të cilave transport rrugor	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
Prej të cilave transport jo-rrugor	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
Të tjera (si bio-gazi, vajrat bimorë, etj.) - ju lutem specifikoni	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
Prej të cilave biolëndë Neni 21(2)	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
Gjithsej	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.0	19.5	39.7

5.2. Kontributi total i pritur nga masat e efijencës së energjisë dhe kursimit të energjisë për arritjen e caqeve obligative të vitit 2020 si dhe trajektorja indikative e përkohshme për pjesën e energjisë nga burimet e ripërtërishme në energji elektrike, ngrohje e ftohje, si dhe transport

Kontributi i pritur nga masat e efijencës së energjisë dhe kursimit të energjisë të trajtuara në këtë PSHVER është nxjerrë nga Plani Kosovar i Veprimit për Efijencën e Energjisë, miratuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik. PKVEE-ja e Kosovës (2010-2018) parasheh cakun indikativ prej 9% të 1021.08 ktoe që të arrihet deri në fund të periudhës (2010-2018). Kështu, sasia e energjisë që Kosova synon të kursejë deri në fund të vitit 2018 është 91,89 ktoe.

Në PSHVER, që është dorëzuar më 2013, janë marrë në konsideratë dy skenarë të konsumit bruto final të energjisë, gjegjësisht “skenari referent” dhe “skenari i efijencës plotësuese të energjisë”. Dallimi ndërmjet këtyre dy skenarëve në vitin 2018 përmban sasinë e pritur të kursimeve finale të energjisë, siç është paraparë me Planin Kosovar të Veprimit për Efijencën e Energjisë.

Konsumi përfundimtar i energjisë sipas sektorit të konsumit fundor është prezantuar në Figurën 2 në pajtim me të dhënat e Eurostat-it.




Figura 2: Konsumi fundor sipas sektorëve më 2015.

Sektori banesor

Sektori banesor është sektori më i madh i konsumit fundor në Kosovë. Më 2015, konsumi fundor i energjisë në sektorin banesor ishte 476 ktoe ose 35% të konsumit total final të energjisë.

Ekzistojnë dy objektiva strategjike që adresojnë çështjet e lidhura me krijimin e kornizës ligjore dhe institucionale për promovimin e efijencës së energjisë.

- Përmirësimi i qasjes në banim të përballueshëm si dhe në pajtim me rrethanat ekonomike të familjeve, si dhe ruajtjen e zonave banesore.
- rregullimi i veprimtarisë së ndërtimit përmes rregulloreve inxhinierike teknike, në përputhje me standardet e BE-së.

Çështjet e lidhura me promovimin e efijencës së energjisë në objekte banesore kolektive do të jenë prioriteti kryesor i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në vitet vijuese.

Një masë në sektorin banesor është përfshirë në PKVEE-në e 3^{te} NEEAP, që parasheh përmirësimin e efijencës së energjisë përmes zbatimit të masave të efijencës së energjisë në objektet banesore. Masat e kursimit të energjisë në objekte banesore përfshijnë izolimin e mureve, ndërrimin e dritareve, izolimin e kulmeve dhe bodrumeve, si dhe aplikimin e sistemeve me BRE.

Sektori i transportit

Sektori i transportit është sektori i dytë më i madh i konsumit fundor në Kosovë. Më 2015, konsumi fundor i energjisë në sektorin e transportit ishte 385 ktoe ose 29% të konsumit total final të energjisë.

Një masë në sektorin e transportit është përfshirë në PKVEE-në e tretë sa i përket përmirësimit të sistemit të transportit publik në qytetin e Prishtinës.

Sektori i industrisë dhe NVM-ve

Industria është sektori i tretë më i madh i konsumit fundor në Kosovë. Më 2015, konsumi fundor i energjisë në sektorin e industrisë ishte 307 ktoe ose 23% të konsumit total final të energjisë.

Një masë në sektorin e industrisë dhe NVM-ve është përfshirë në PKVEE-në e tretë, duke u fokusuar tek përmirësimi i efijencës së energjisë përmes zbatimit të masave të efijencës së energjisë në NVM. Masat për kursimin e energjisë në NVM parashohin ndërrimin e njërive të vjetra e joefikase të prodhimit dhe zbatimin e zgjidhjeve të ndriçimit efikas.

Sektori terciar (i shërbimeve)

Më 2015, konsumi fundor i energjisë në sektorin e shërbimeve ishte 148 ktoe ose 11% të konsumit total final.

Masat e efijencës së energjisë në sektorin terciar, që përfshijnë administratën publike, institucionet shëndetësore, etj., që duhet të kenë rëndësi specifike për projektet investuese të PKVEE-së së tretë. PKVEE-ja e tretë përmban shtatë masa implementimi, për të cilat ndahen fondet kryesisht nga buxheti i shtetit, buxhetet komunale, BB-ja dhe KfW-ja. Mbi 200 objekte do të renovohen si rezultat i implementimit të projekteve investuese brenda atij aktiviteti. 7 masat e mëposhtme janë përfshirë në sektorin terciar në PKVEE-në e tretë:

- Përmirësimi i EE-së në ndërtesat e institucioneve publike në nivel qendror (projekt i BB-së).
- Përmirësimi i EE-së në ndërtesat e institucioneve publike në pesë vende në nivel qendror (MZHE).

- Përmirësimi i EE-së në ndërtesat e institucioneve publike në nivel qendror (MAP, MD, QKUK, MPB dhe UP).
- Përmirësimi i EE-së në ndërtesat e institucioneve publike në nivel qendror, në sektorin e ndriçimit.
- Përmirësimi i EE-së në ndërtesat e institucioneve publike në nivel lokal (katër komuna, projekt i KfW-së).
- Përmirësimi i EE-së në ndërtesat e institucioneve publike në nivel lokal (KASH).
- Përmirësimi i EE-së në ndriçim publik në nivel lokal .